The Albanian

VITI I 24 I BOTIMIT 10 SHTATOR 2026

Tel: 020 7018 7929 30 Avenons Road London E13 8HT

LAMTUMIRË DR. DAUT DAUTI AMBASADOR I SHKËLQYER I SHQIPTARËVE TË BRITANISË

Speciale faqe 2-12
Petrit Kuçana
Mal Berisha
Ilir Kapiti
Ida Ceku
Bashkim Metalia
Arben Manaj
Shef Domi
Emanuel Bajra
Imer Mushkolaj
Bejtullah Destani
Flutura Bara
Agim Morina
Halil Matoshi
Emin Azemi
Agron Shala
Ismet Azizi
Arbër Ramadani
Fjolla Spanca
Fatmir Ismaili
Shaban Maxharraj



FASHIZMI NUK DUHET KËRKUAR TEK REVOLTA E PROTESTUESVE POR NË KUVEND!

IRENA BEQIRAJ



NJË MOMENT VENDIMTAR PËR SHQIPËRINË

DITMIR BUSHATI



MAKE ALBANIA AFFORDABLE

ANDI BEJTJA



PIKTORI DUHET TË BIE QË SHQIPËRIA TË MUND TË NGRIHET

KIM MEHMETI



GJENERALI QË VDIQ DHE VAZHDON TË JETOJË

VETON SURROI



The Albanian newspaper in London
THE ALBANIAN
www.thealbanian.co.uk

www.thealbanian.co.uk
albania7@gmail.com
Tel: 020 7018 7929

DAUT DAUTI ISHTE DHE MBETET AMBASADORI MË I SHKËLQYER I SHQIPTARËVE TË BRITANISË



PETRIT KUÇANA



Kurrsesi nuk dëshiron të besosh, atë lajmin e largët, të kobshmin lajm, edhe pse të është dukur se gati-gati kemi qenë të përgatitur.
Duket se u këput, u pre pabesisht një udhë, një rrugëtim i përbashkët me një koleg, mik, prej më shumë se dy dekadash.
E cila fjalë do të ishte më plotpërmbushësja e asaj gjendjeje sfilitëse, teksa përpiqesh të kumtosh këtë lajm të kobshëm me miqtë e tjerë. 'Dauti na la'.
Çuditërisht mbamendja të kthehet tek 'gajreti' që përpiqesh të gjesh, kur nja dy vite më parë, ai me mënyrën e tij na tregoi se mjekët nuk i kanë dhënë lajme të mira për shëndetin.
...E kishim mbaruar intervistën, e mbase as unë e as ai... nuk donim ta besonim se ajo do të ishte intervista e fundit.
Ka qenë një yshtje, për të përmbledhur gjithçka në atë intervistë 'Udhëtimi im'.
Pas disa telefonatash ku përpiqeshim të përqendroheshim tek elementet më thelbësore, Dauti ishte krejtësisht i qetë. "Hajt se flasim për çfarë të duash. Kur të vjmë andej i shikojmë edhe njëherë ato stacionet…"
Mes gazetarise, historisë, studimeve, letërsisë?
Nga t'ia fillonim?
Mbi dy dekada njohjeje të një përsonazhi aspak të zakonshëm, duhet të përmblidhen në disa pyetje thelbësore dhe se përgjigjet duhet të ishin në formatin e rrëfimit, natyrisht të kufizuara në kohë…
Dauti dinte të shndërronte rrëfimin e tij ,në një rrëfim magjik dhe duket se gjithkush kthehej natyrshëm, në ëndjendjekës të tij.
Nuk besohet se në botën shqiptare, të ishte dikush që kishte më shumë njohuri mbi marrëdhëniet shqiptaro-britanike sesa Dr. Daut Dauti.
E pikërisht mbase këtu fillon edhe zanafilla e rrëfimit për Dautin, i cili ishte ndër shqiptarët e parë, që u gjend në Britani dhe se ishte një ndër kontributet e jashtëzakonshme të tij. Atëherë filluan intervistat me shqiptarët e hershëm, ata të moçmit, që kishin ardhur pas luftës së dytë botërore.
Me tepër se kaq, ishin intervistat me miqtë britanikë, të moçmit britanikë që mbesin padyshim thesare të çmuara për historiografinë, e pse jo edhe për gazetarinë shqiptare.
Pa kontributin e tij, shumë e shumë gjëra do të mbeteshin të pathëna, të pashkruara, të panjohura.
Kontributi i tij mbetet i jashtëzakonshëm si aktivist para, gjatë dhe pas luftës së Kosovës, që nga momentet për themelimin e komunitetit shqitpar në Britani (kur në atë kohë kishte vetëm disa dhjetëra të tillë), e deri tek daljet ne televizione britanike, për mbrojtjen e çështjes shqiptare.
Rrallë në shqiptari mund të gjendet një gazetar me një eksperiencë të tillë, me angazhim të tillë, qoftë në Britani e më pas në Kosovë, në rolin e zëdhënësit të qeverisë etj etj.
Në çdo moment Dauti ishte reporter, gazetar, opinionist, … në çdo gjini të gazetarisë ai dinte të shkëlqente.
Daut Dauti ishte dhe mbetet ambasadori më i shkëlqyer i shqiptrëve të Britanisë.

I tillë mbeti edhe kur mori titullin PhD, por tashmë studiuesi Daut Dauti ishte shumë më shumë se gazetari Dauti, ndonëse të dy profesionet i rrinin mirë, gati gati plotëpjestim i njëri-tjetrit.
Librat e publikuar, dëshmi e ndërthurjes së profesionit me pasonin, që ashtu krahas, plotësonin staturën e tij prej akademiku, (por që kurrë nuk dëshironte të njihej si i tillë.
Madje madje e kishte mbase më shumë pasion edhe letërsinë që, duket se i hyri pak në hak…
Mbase nuk iu dha koha e mjaftueshme letërsisë, por siç thoshte edhe në intervistë… 'kushdedi sa kohë na ka mbetur'…. Eh koha.. Po e vrazhdë, e pamëshirshme, që duket se na preu në besë, të gjithëve…
A mund të gjendet një mik, apo qoftë edhe i njohur, që të mos mbajë mend humorin e tij të jashtëzakonshëm?

Ai kishte një rrëfim të jashtëzakonshëm, një kombinim të ngjarjeve jetësore gërshetuar mjeshtërisht me humorin që e karakterizonte.
Ne kemi patur privilegjin ta kemi mik, prej më shumë se dy dekadash, dhe secili nga 'çunat' mezi prisnim ta takonim, kudo që të ishte, qoftë tek Besnik Ora, e deri tek Flamuri, i cili ishte larg, në anën tjeter të Londrës apo siç dinte të thoshte Dauti 'pas shpinës



së Zotit'.
E kushedi sa shumë e shumë kujtime mbeten, nga ato më të dhimbshmet e deri tek momentet, që në jetën e një njeriu nuk mund të harrohen kurrë.
Padyshim edhe ato meraqet, planet që nuk mundëm t'i realizojmë, që bashkë me çunat të mund të shkonim tek shqiptarët e Sanxhakut apo të Preshevës…
'E sa të bëj pak më mirë mund të bëjmë edhe 'auditoriumin' apo promovimin e librave…-kumtonte Dauti.
Sërish koha… e ashpra kohë… e pamëshirshmja kohë…

Dauti do të na mungojë shumë më shumë sesa mund të mendohet.
The Albanian i shpreh ngushëllimet familjarëve dhe të gjithë miqve që e njohën Daut Dautin.

Ik Daut Ik.. e ne do të mbetemi andej nëpër hapësirat ku do të njehet fort, po shumë fort mungesa jote, bashkë me kujtimet që sfidojnë kohën, dhimbjen e ngadhënjejnë edhe mbi vdekjen.

Lamtumirë miku ynë!

DO TË TË KUJTOJMË PËRGJITHMONË...

IDA CEKU

U largove shumë herët, me ende kaq shumë shpresa, ëndrra dhe dëshira për jetën.
Dhe deri në fund të saj, ruajte optimizmin, forcën dhe besimin se jeta, pavarësisht vështirësive, kishte ende shumë për të ofruar.
Do të të kujtojmë gjithmonë jo vetëm për dijen e jashtëzakonshme, letërsinë, artin, fjalën dhe kontributin tënd të çmuar si gazetar e shkrimtar, por mbi të gjitha për njeriun që ishe.
Një njeri me zemër, me kulturë, me thjeshtësi dhe me një aftësi të rrallë për t'iu afruar njerëzve dhe për t'i bërë ata të ndiheshin mirë.
Në çdo bisedë, intervistë apo tavolinë ku ishe i pranishem, sillje diçka të veçantë.
Dije të dëgjoje, të komunikoje, të frymezoje dhe të sillje një këndvështrim që i jepte kuptim edhe momenteve më të zakonshme.
Dije të ishe vetvetja dhe, nëpërmjet thjeshtësisë tënde, të krijoje një lidhje të sinqertë me njerëzit.
Edhe kur jeta nuk ishte e lehtë, ti ruaje optimizmin dhe atë forcë të brendshme që na kujtonte, se shpresa nuk duhet humbur kurrë.
Ti nuk u jepje vetëm fjalë njerezve; u jepje motivim, frymëzim dhe besim.
Do të kujtojmë për bisedat tona, për kafetë, për diskutimet e gjata dhe për mënyrën tënde të veçantë, për ta kthyer edhe një situate të vështirë në një moment më të lehtë e me kuptim.
Do të na mungojë pozitiviteti yt, frymëzimi yt, motivimi yt dhe mënyra se si dije t'u jepje njerëzve force, për të parë përpara.
Mbi të gjitha, do të mbetet kujtimi i një njeriu që, edhe në perballje me vështirësitë e veta, vazhdoi të besojë tek jeta dhe t'ua përcillte këtë besim të tjerëve.
Një njeri më kaq shumë dije, kulturë, art, zemër dhe dashuri për jetën nuk harrohet kurrë.



U prehsh në paqe miku ynë.

NJË HUMBJE E PARAKOHSHME DHE E DHIMBSHME...

FLUTURA BARA

Është e vështirë të flasësh në kohën e shkuar për një njeri si Daut Dauti një intelektual i rrallë, një njeri i mirë dhe një shpirt me një sens të veçantë humori.

Do t'i kujtoj me shumë mall takimet tona si group gjatë festave të fundvitit.
Më kujtohet Krishtlindja e fundit kur ishim bashkë: batutat e tua, historitë, humori dhe ato tema aq të bukura e interesante që dije gjithmonë t'i hapje.

Por ajo që të karakterizonte më shumë ishte mënyra se si i përfshije të gjithë në bisedë. Askush nuk ndihej jashtë rrethit kur ti ishe aty.
Kishe atë dhunti të rrallë për të sjellë pozitivitet kudo që ndodheshe.

Mençuria jote nuk kishte nevojë të imponohej; ajo ndihej në fjalët, humorin dhe mënyrën si komunikoje me njerëzit.
Ndoshta pikërisht për këtë ishe kaq i respektuar në çdo rreth shoqëror.

Ka njerëz që, kur largohen, lënë pas heshtje.

Ti lë pas biseda që do të kujtohen, të qeshura që ende jehojnë dhe respektin e shumë njerëzve që patën fatin të të njihnin.
Do të të kujtoj gjithmonë me buzëqeshje, sepse kështu të kujtoj më së shumti duke sjellë dritë, humor dhe mendim të mençur mes nesh.
U prehsh në paqe, Daut.
Do të mungosh shumë.
U prehsh në paqe miku ynë.

TELEGRAM NGUSHËLLIMI NGA PRESIDENCA E KOSOVËS

E nderuar familje Dauti,

Me pikëllim të thellë mora lajmin për ndarjen nga jeta të Dr. Daut Dautit. Humbja e tij prek jo vetëm familjen dhe njerëzit e tij të afërt, por edhe jetën intelektuale e publike të Kosovës, së cilës ai i shërbeu për dekada me dije, integritet dhe përkushtim.
Daut Dauti ishte prej atyre intelektualëve që lidhjen me Kosovën e kishin sa përkatësi aq edhe përgjegjësi. Në vitet më të rënda për vendin tonë, ai e vuri fjalén dhe profesionin e gazetarit në sherbim të së vërtetés per Kosovën, duke kontribuar që zëri i saj të dëgjohej edhe në Britaninë e Madhe dhe më gjerë. Më pas, si historian dhe studies, vazhdoi t'i sherbente po së njejtës të vertetë, tashmë përmes dokumentit, argumentit dhe kërkimit shkencor.
Ne veprën e tij, historia e shqiptarëve dhe marredhëniet shqiptaro-britanike gjetën një studies serioz e këmbëngulës. Në jetën publike, Kosova pati tek ai një zë te matur dhe të besueshëm. Ndërsa ata që e njohën nga afër do ta kujtojnë edhe për njerëzinë, urtësinë dhe respektin të cilin e përcillte dijen e tij.
Daut Dauti jetoi për shumë vite larg Kosoves, por kurrë larg cështjeve të saj.
Pikërisht kjo lidhje e pandërprerë me vendin, përmes gazetarisë, studimit dhe angazhimit qytetar, mbetet pjesë e trashëgimisë që ai na le.
Ne emer të institucioneve te Republikes së Kosovës dhe në emrin tim personal, ju shpreh ngushëllimet më të sinqerta juve, familjes Dauti, miqve, kolegëve dhe bashkepunëtorëve te tij.
Ne këte dhimbje të madhe, ju qoftë ngushellim krenaria për jetën dhe veprën që la pas.
I përjetshëm qoftë kujtimi për Dr. Daut Dautin.

Merespekt,
Albulena Haxhiu
Ushtruese e Detyrës së Presidentes së Republikës së Kosovës



REPUBLIKA E KOSOVËS - PRESIDENTJA
REPUBLIC OF KOSOVO - THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO - PREDSEDNICA

01/07-350-01/26
02 09 26

Prishtinë, 2 shtator 2026

TELEGRAM NGUSHËLLIMI

E nderuar familje Dauti,

Me pikëllim të thellë mora lajmin për ndarjen nga jeta të Dr. Daut Dautit. Humbja e tij prek jo vetëm familjen dhe njerëzit e tij të afërt, por edhe jetën intelektuale e publike të Kosovës, së cilës ai i shërbeu për dekada me dije, integritet dhe përkushtim.

Daut Dauti ishte prej atyre intelektualëve që lidhjen me Kosovën e kishin sa përkatësi aq edhe përgjegjësi. Në vitet më të rënda për vendin tonë, ai e vuri fjalën dhe profesionin e gazetarit në shërbim të së vërtetës për Kosovën, duke kontribuar që zëri i saj të dëgjohej edhe në Britaninë e Madhe dhe më gjerë. Më pas, si historian dhe studies, vazhdoi t'i shërbente po së njejtës të vërtetë, tashmë përmes dokumentit, argumentit dhe kërkimit shkencor.

Në veprën e tij, historia e shqiptarëve dhe marrëdhëniet shqiptaro-britanike gjetën një studies serioz e këmbëngulës. Në jetën publike, Kosova pati tek ai një zë të matur dhe të besueshëm. Ndërsa ata që e njohën nga afër do ta kujtojnë edhe për njerëzinë, urtësinë dhe respektin të cilin e përcillte dijen e tij.

Daut Dauti jetoi për shumë vite larg Kosovës, por kurrë larg çështjeve të saj. Pikërisht kjo lidhje e pandërprerë me vendin, përmes gazetarisë, studimit dhe angazhimit qytetar, mbetet pjesë e trashëgimisë që ai na lë.

Në emër të institucioneve të Republikës së Kosovës dhe në emrin tim personal, ju shpreh ngushëllimet më të sinqerta juve, familjes Dauti, miqve, kolegëve dhe bashkëpunëtorëve të tij.

Në këtë dhimbje të madhe, ju qoftë ngushëllim krenaria për jetën dhe veprën që la pas.

I përjetshëm qoftë kujtimi për Dr. Daut Dautin.

Me respekt,

Albulena Haxhiu

Ushtruese e Detyrës së Presidentes së Republikës së Kosovës

LAMTUMIRË DR. DAUT DAUTI



BASHKIM METALIA

Ishte e trishtueshme dhe e papërballueshme kur mora lajmin e hidhur , nga miku im Petriti Kuçana që Dauti na la. Nuk doja ta besoja! Një nga ato lajme të kobshme që njeriu yt ka ndërruar jetë, dhe...dorëzohesh në dhimbje! Gjithë këto vite që kemi kaluar së bashku asnjëherë nuk ishin të mjaftueshme, sepse me Dautin, koha ishte një nocion i pakët …

"Tung Bashkim, si je? Ka kohë që s'jemi pa u pa e as dëgju. As me Petritin jo" – më shkruante Dauti shpesh herë kur e "tepronim" që nuk gjenim kohë për tu takuar në ndonjë vend – s'ka rëndësi se ku.

Dhe tani kur e mendon se këto takime kanë ngrirë përfundimisht, ngulfatesh nga boshllëku i marrëdhënies njerëzore. Daut Dauti dinte të krijonte dhe t'i mbante këto marrëdhënie.

Dauti kishte atë shpirtin e njeriut të pastër , të dëlirë dhe dashamirës.
Nuk dua të flas sot shume për intelektualizmin e tij sepse ishte i papërsëritshëm në llojin e vet.

Nuk dua të flas tani edhe për vet faktin se vlerat e tij intelektuale dhe akademike ia njohin botërisht , bashkëkombës dhe të huaj, edhe pse në të ardhmen do të elaborohen dhe studiohen veprat dhe punimet e tij shkencore nga akademikë dhe studiues.

Ikja e tij nga kjo botë të ligështon por në anën tjetër ndihesh krenar për miqësinë dhe kohën që kemi kaluar së bashku.

Bisedat dhe me të ishin një nxënje edukuese dhe në të njëjtën kohë alegoria dhe shtjellimi i ngjarjeve dhe situatave të ndryshme jetësore , vetëm Daut Dauti dinte ti shtjellonte në mesin tonë.

Diapazoni dhe njohuritë e përpikta intelektuale ishin një leksion fakultativ por në vetvete brumoseshin thellë në mendje.

Ikja e tij nga kjo botë është e padrejtë, sepse ai kishte akoma dhe shumë për të na dhënë. Diapazoni i tij intelektual ,patriotizmi dhe emancipimi shoqëror ia dekoronin karakterin dhe vlerat.

Ai i zotëronte këto dije me intelektin e tij në mënyrë të përsosur akademike , me forcën e argumentit dhe stil të veçantë narrativ.

Studiues , historian , gazetar dhe publicist i paepur i çështjes kombëtare dhe më gjerë dhe një mjeshtër i fjalës që vetëm ai dinte ta latonte aq bukur.

Kontributi që i dha historiografisë dhe publicistikës do të ngelin një fanar ndriçues dhe përjetësisht të vyeshme në botën intelektuale dhe akademike.
Padyshim ka lënë gjurmë që nuk do të harrohen por ikja e tij fizike është dhe do të ndihet nga familjarët , miqtë dhe të afërmit e tij.

Do të na mungojnë ato netë të gjata bisedash , humori , do të na mungojnë shkëmbimi i mesazheve të pafundme, do na mungojë energjia dhe njerzillëku i Daut Dautit.

Do të doja sërish t'i ktheja përgjigje për vendin e takimit për një kafe ... por Zoti e deshi për vete , sepse ai të mirët i do pranë vetes.

Ngushëllime familjes, miqve dhe dashamirësve të tij.

Lamtumira nuk është fundi, por dhimbja e një kujtimi që do të jetojë përgjithmonë.

Daut, të qoftë i lehtë dheu yt i lindjes

Do na mungosh!

DAUT DAUTI , MIKU QË LA PAS FJALËT...

SHEF DOMI

Ka lajme që i lexon, i dëgjon dhe, për disa çaste, mendja refuzon t'i pranojë. Kështu ishte edhe lajmi për Daut Dautin.
Kur Petrit Kuçana më dha lajmin se Dauti kishte ndërruar jetë, për një moment mbeta pa fjalë. Nuk doja ta besoja. Ndoshta sepse, në mendjen time, Dauti ishte nga ata njerëz që nuk mund të mungonin. Ishte gjithmonë aty me një mesazh, nje histori, një bisedë të gjatë, një mendim të papritur apo atë mënyrën e tij të veçantë për ta parë jetën, dhe treguar atë.
E kam njohur Dautin që ne rininë time, secilën herë e dëgjoja me kureshtje, shpesh pa dashur që biseda të përfundonte.
Çdo histori e tij kishte një mësim, një kujtim, një batutë apo një copëz nga jeta.
Ai dinte të fliste për historinë, njerëzit dhe kohët që kishte përjetuar, sikur i kishe përpara syve.
Takimet tona ndër vite ishin nje eksperiencë në vete ku do na mungoj shumë. Unë u rrita ngadalë, përmes bisedave, takimeve, punës, të qeshurave dhe atyre netëve të gjata ku një kafe mund të kthehej në orë të tëra diskutimi.

Shpesh kur takoheshim më thoshte :
"Tung Shef, si je? Si ie ke ato ushtarët e vegjël, a po rriten cunat (femijët)."
Sot, kur mendoj për të, më duket e pabesueshme që ato takime dhe biseda nuk do të përsëriten më.

Dauti ishte intelektual i madh, studiues, historian, gazetar, publicist dhe shkrimtar. Kishte një kulturë të gjerë dhe një mënyrë të rrallë të argumentuarit. Fjala e tij nuk ishte thjesht fjalë; ajo vinte e menduar, e peshuar dhe e formuar me kujdes.
Daut, miku im, faleminderit për vitet e miqësisë, për bisedat, për dijen, për humorin, për takimet dhe qebapat dhe për të gjitha ato momente që sot janë kthyer në kujtime.

Ti ike shumë herët.
Por nuk ike pa lënë gjurmë.

Fjala jote do të mbetet. Shkrimet e tua do të mbeten. Kujtimi yt do të mbetet.
Dhe për ne që patëm fatin të të kishim mik, do të mbetet edhe ajo ndjesia se në një pjesë të jetës sonë ka qenë një njeri që nuk do të zëvendësohet më.
Lamtumirë, Daut.
Të qoftë i lehtë dheu i vendlindjes.
Allahu e mëshiroftë, ia faltë gabimet dhe e shpërbleftë me Xhenet. U prehtë në paqe dhe kujtimi i tij qoftë gjithmonë i gjallë në zemrat e atyre që e deshën.

LAMTUMIRË DAUT!

AGIM MORINA

Në Londër mbylli sytë Daut Dauti, historian dhe gazetar shqiptar.
Daut Dauti lindi në Kokaj të Gjilanit, shkollën fillore e kreu në Prishtinë dhe të messmen në Gjilan. Studimet i vazhdoi në Prishtinë ndërsa studimet pasuniversitare në Thames Valley University të Londrës.

Në Universitetin e Lidsit doktoroi me distertacionin "Politika e Jashtme Britanike dhe Çështja Shqiptare" ("The British Foreign Policy and the Albanian Question 1876–1914"), që u botu si libër me 2012 në Shkup.
Punën e tij prej gazetari e nisi si bashkëpunëtor në gazetën e studentëve "Bota e Re. Më vonë vazhdoi bashkëpunimin me revistën "Zëri". Gjatë viteve 1993-94 ishte gazetar i revistës "Forumi".
Kur u zhvendos në Londër, ishte korrespondent i kësaj gazete nga Britania e Madhe (1994-99). Në vitet 1999-2001 punoi si redaktor në Institutin për Raportime të Paqes e të Luftës (IWPR: Institute for War and Peace Reporting) në Londër dhe themeloi zyrën e këtij instituti në Prishtinë. Për dy vite ka shërby si sekrater i përgjithshëm i Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës.
Gjatë vitit 2002 ka qëndru në Dejton, në Kettering Foundation, ku ka ba hulumtime shkencore në lidhje me median dhe demokracinë. Gjatë vitit 2005 ishte këshilltar për media dhe zadhanës i qeverisë së Bajram Kosumit. Vitet e fundit ka punu në Ogranizatën Ndërkombëtare të Migracionit (IOM: (International Organisation for Migration) dhe ka qenë i pranishëm vazhdimisht me shkrime e artikuj rreth çashtjeve të ndryshme të shoqërisë sonë.



Asht autor i një varg veprash:
"Reflektime Shqiptaro-Britanike", Prishtinë, 2001
"Unioni Evropian – Nga Ideja në Realitet", Prishtinë, 2001
"Lufta për Trepçën", Prishtinë, 2002
"Building an Independent Media in Kosova - Ngritja e mediave të pavarura në Kosovë", Prishtinë, 2002
"Assamblies and Ancient Deliberation According to Code of Lek Dukagjini;
"Çështja shqiptare në diplomacinë britanike, 1877 – 1880". Shkup, 2012
"Nëpër gjethe kujtimesh", Prishtinë, 2026
Daut Dauti ishte një nga përfaqësuesit ma të randësishëm të bashkësisë shqiptare në Britani. Kishte rreth të gjanë miqsh shqiptarë e anglezë. Me shkrimet e tija mbrojti vazhdimisht kauzën shqiptare, me hulumtimet e tij nëpër arkiva nxori në dritë shum dokumente me randësi për historinë shqiptare dhe marrëdhaniet shqiptaro-britanike. Zani i tij u ndëgju shpesh në mediat britanike dhe në forumet e debatet e ndryshme para e gjatë luftës në Kosovë.
Me Dautin u njohëm në Prishtinë në vitin 1993, nëpërmjet shokut tjetër, Haqif Mulliqit. Qysh prej atëherë patëm një miqësi të vazhdueshme. Një kohë kemi punu bashkë në revistën "Forumi".
Ishte i kandshëm në biseda, i mprehtë në debate dhe shpirtgjanë. Banesa e më vonë shtëpia e tij i kanë pasë dyert e hapuna përherë për çdo shqiptar që vinte si refugjat në Britani. Tue qenë se një kohë ka punu edhe si përkthyes në zyrat e emigracionit, shpesh kthehej në shtëpi me ndonjë shqiptar që nuk kishte kah t'ia mbante, kështu nëpër dyert e shtëpisë së tij kanë kalu me qindra shqiptarë, të njohun e të panjohun.
Me vdekjen e Dautit, bashkësia shqiptare në Britani humbi një gazetar të angazhuem dhe një historian të vyem, ndërsa shokët një mik të paharrueshëm.
Daut, faleminderit për të gjitha dhe lamtumirë!

LAMTUMIRË SHOQ!

HALIL MATOSHI

1.
Kenka shue Daut Dauti, kosovari i Kokajve në Londër - gazetari, autori dhe miku, me të cillin kemi punu bashkë në "Zëri" (ishte korrespondent nga Londra) në vitet e stuhishme të Kosovës.
Gazetar, i pasionuem mas historisë - patëm bâ disa polemika rreth nacionalizmit defansiv shqiptar vs nacionalizmit të ri që po lindej e po rritej me moshën e shtetit kosovar; por tue ruejtun ndershmënisht miqësinë e vjetër - baraspeshimin e fjalës.
2.
Në vitin 2000 ishim bashkë në Gjenevë me nji grup gazetarësh që mbijetuen luftën.
Në terracën e hotelit ku buejshim, po e pijshim nga nji birrë e Dauti na tregojke nji rrfim nga vendlindja e tij, me dhampirë...
3.
Dauti tundi kryet tue pështpëritin se lugetnit ktheheshin gjithmonë në fshatin e tij, kur hâna fshihej mas mjegullës.
Enveri (Rrobelli) keshke me zâ...
Në atë çast, nji rrfe verbuese goditi nji bredh në afërsi dhe ai u shkund si knues krekosës, tue e shndru errsinën në shkundullimë e tue lanë mas nji erë shkrumi.
Rrëmbyeshëm hymë brenda... vazhduem llafin..., për shtriga e lugetna ballkanikë...
4.
Në mes të asaj nate të trazueme, pata



nji vegim a nji lloj andrre t'keqe, diku në skutat ma t'errsueta të Kampit "Zabela" të Požarevac-it, në Serbi.
Gani Bytyçi po fliste me banakieren, e cila po i thojke te ishin nga jugu, se dal-loheshin për nga e folmja!
Ajo ishte nga Požarevac i Serbisë, m'tha Ganiu.
- U afrova dhe me brrylat në banak, i thash, po, edhe unë vij nga Požarevac - ajo u step!
- Kam qenë peng lufte atje.
Ajo e kuptoi kontekstin dhe na kërkoi falje, se mos na kishte shqetësu, me nifar sinqeriteti të grave t'Ballkanit.
Ganiu e di se e ka nji tregim për këtë rast, kur koinçidenca të zatet me "anmikun", si në letërsi.
5.
I humbun në lajmet e ditës, m'shkruejti Enveri.
- Dauti paska dekë!?
Dje Agroni m'tha se i ishte lajmnu grueja e Dautit nga Londra, 'përcillja t'falat Agronit, po des!' - Dauti.
Pijta nji gllënkë uji.
M'u bâ se m'u lidh nye në fyt diçka, sikur me t'shku keq uji.
Shembëllyese e brishtësisë së jetës asht uji.
Nuk ngop po s'jetohet pa të.
6.
Rishtas m'u përserit vegimi sod.
Lajmësi hapi derën dhe tha me belbëzim se rrfyesi për dhampirat sapo kishte dekë në mërgim; në atë dakik, nga faqet e librit të tij të hapun mbi tryezë nisi me rrjedhë nji ujë i madh dhe i zi deti, tue përmbytë dhomën e kujtesës me aromën e krypës dhe të valëve të largëta, valë kujtese për vendlindjen, që Daut Dauti nuk i harroi kurrë.
Dita u err.

PS
Lamtumirë Daut kudo që je tue pi kafen sod.
Kafen e kujtesës sonë!

LAMTUMIRË DR DAUT DAUTI!

MAL BERISHA'

Paska ndërruar jetë një ndër bijtë më të mirë të Kosovës: historiani, veprimtari, shkrimtari dhe patrioti Daut Dauti.
Prej kohësh ai vuante nga një sëmundje e pashërueshme. Gjatë muajve të fundit e telefonoja herë pas here për të mësuar rreth gjendjes së tij shëndetësore. Optimizmi dhe qëndresa e tij ishin të pashoqe.

Me këtë rast, i shpreh ngushëllimet e mia më të sinqerta familjes së tij: bashkëshortes, fëmijëve, nipërve dhe mbesave, si dhe të gjithë të dashurve, miqve, shokëve dhe bashkëpunëtorëve të tij.
Ndiej dhimbje të thellë për ndarjen e tij të parakohshme nga jeta, por njëkohësisht edhe krenari që pata rastin të punoja përkrah tij në Londër dhe të bënim së bashku punë të mira për Kosovën dhe Shqipërinë.
U prehtë në paqe!

'Ish Ambasadori i Shqiperisë në Londër

The historian Daut Dauti presents his book at the Albanian Embassy





21 March 2013: Embassies of Kosova and Albania organise a book launch of: *"Albanian issue in the British Diplomacy, 1877 – 1880"*, written by Daut Dauti.

ILIR KAPITI'

Me shumë dhimbje morëm lajmin për ndarjen nga jeta të Daut Dautit.

Komuniteti ynë në Mbretërinë e Bashkuar ka humbur një pjesëtar të dalluar, një veprimtar të kahmotshëm dhe një njeri të përkushtuar ndaj kauzës së Kosovës dhe të kombit shqiptar.
Kontributi, veprimtaria dhe përkushtimi i tij do të mbeten gjatë në kujtesën e të gjithë atyre që e njohën dhe bashkëpunuan me të.

Familjes, të afërmve, miqve dhe bashkëveprimtarëve të tij u shprehim ngushëllimet më të sinqerta.
U prehtë në paqe dhe i qoftë i përhershëm kujtimi!
'Ambasador i Kosovës Londër

ME RASTIN E NDARJES NGA KJO BOTË TË PUBLICISTIT DAUT DAUTI

ENVER ROBELLI



Me shumë dhimbje dhe shumë kujtime të paharruara lexova lajmin për vdekjen e publicistit dhe historianit Daut Dauti, me të cilin kemi bërë një shteg të gjatë të jetës sonë: si kolegë, si bashkëvendas (nga Anamorava), si udhëtarë transballkanikë, si kureshtarë të çdo gjurme shqiptare në histori dhe si mbrojtës të kauzës së popullit të Kosovës për liri.
Në udhëtimet e shumta që kam bërë si gazetar i mediave zvicerane dhe gjermane nëpër shumë vende të Ballkanit, Dauti shpesh nuk përtonte të më bënte shoqëri.

«Shkojmë?», thosha unë.
«U nisëm!», thoshte ai.

Më 2005 shkuam në Srebrenicë, në 10-vjetorin e gjenocidit serbomadh ndaj popullsisë boshnjake. Dauti si zyrtari i parë i Qeverisë së Kosovës në këtë ceremoni (atëbotë ishte zëdhënës i Qeverisë së kryeministrit Bajram Kosumi), unë si gazetar.

Para nesh ishte mbarë bota: 50 mijë boshnjakë, të shpërndarë anekënd botës, duke kërkuar varre dhe arkivole; diplomati amerikan Richard Holbrooke, ministri i Jashtëm britanik Jack Straw dhe homologë të tij nga Holanda, Franca, Suedia e Turqia.

Në Vukovar pimë kafe me një shqiptar nga një fshat i Maqedonisë, të cilit çetnikët ia kishin djegur shtëpinë, ndërsa autoritetet kroate ende nuk po ia jepnin lejen për të ndërtuar në pronën e tij.
Në Zagreb shkuam në një ditë dimri, pasi në dhjetor 2005, në Spanjë, ishte arrestuar gjenerali kroat Ante Gotovina. Ndërsa po hanim mëngjes, bëmë një gabim: kërkuam «hleb» dhe jo «kruh» (fjalë kroate për bukë). Një gabim që nuk e përsërita kurrë, as gjatë pesë viteve të jetës sime në Zagreb si korrespondent i «Tages-Anzeiger» (Zürich) dhe «Süddeutsche Zeitung» (München).

Njëherë udhëtuam nga Zürichu në Prishtinë pranë bregdetit adriatik kroat. Na zuri nata në trevën e Istrës, në Kroaci, dhe këtu bëmë një sy gjumë. (Lajmi për vdekjen e tij më gjeti në Opatija, një qytet me plot histori, të cilin e kishim vizituar dhe admiruar.)
Atëbotë, në fillim të vitit 2006, ishim pak më të rinj dhe shumë mendjelehtë. Hymë në Kosovë dhe një shenjë në veturë na bënte thirrje të ndaleshim në një pompë benzine.
«Hajt se na çon deri në Prishtinë», thashë unë.
«Po more», tha ai.
Mbetëm te Kroni i Mbretit. U ndal një djalë i ri, e kuptoi mirë hallin tonë dhe, pas pak, na solli nja 20 litra naftë.
«Drenica nuk ju lë në lloç», tha me humor dhe na uroi rrugë të mbarë.
Dauti kishte një humor origjinal, shpesh edhe mrekullisht bizar. U kthyem njëherë vonë në Gjilan dhe pamë në qendër një burrë që po pastronte rrugët me ujë.
«Ndalu pak», tha Dauti.
Dhe e pyeti tipin nëse e kishte parë një «tip me BMW të kuqe».
Punëtori i pasherr tha:
«Jo, tybe.»

Këtë pyetje e bënte shpesh në vende të ndryshme dhe ishte vetëm një pikënisje për humor të hollë. Njëherë ndodhi e papritura. Po prisnim rreth orës tre të natës të merrnim nga një burek në një furrë buke në Gjilan.

«A e ke pa një tip me BMW të kuqe?», iu drejtua Dauti bukëpjekësit.
«Pasha Zotin, pak më herët ishte njëri me BMW të kuqe», u përgjigj ai.
Dhe, ndërsa po shijonim burekët dhe po hapnim tasat me jogurt, papritmas para lokalit u ndal një tip me një BMW të kuqe. Kishte harruar diçka dhe erdhi ta marrë.
Qeshëm pa fund.
Për anën tjetër - profesionale - të Daut Dautit kanë shkruar sot gjatë ditës shumë kolegë, andaj po kufizohem në disa fakte që do të mbesin.
Ai ishte gazetar i mirë. Publicist pafund kureshtar. Kishte jo vetëm ambicie, por edhe talent letrar. E mbrojti dhe e shpjegoi historinë e Kosovës kudo ku iu dha rasti dhe ku kishte mundësi në botën anglosaksone.
Doktoroi në histori në Angli.
Një ndjenjë hidhësie mbetet: Kosova nuk e shfrytëzoi potencialin e tij. Sepse kjo është koha e huliganëve dhe e atyre që shtyhen me bërryla. Dauti nuk ishte i tillë.
Raportoi për «Zërin» nga Londra, shkroi për Institute for War and Peace Reporting (IWPR), hulumtoi në Britani të Madhe e në SHBA, por nuk rrahu gjoks.

Sot, gjenerata e TikTokut nuk është fare e vetëdijshme nga vjen liria dhe demokracia dhe kush ishin zëdhënësit e saj.

Kur në tetor të vitit 2000 u mbajtën zgjedhjet e para në Kosovën e çliruar, Daut Dauti ishte zëdhënës i Komisionit të Zgjedhjeve (atëbotë nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e OSBE-së).

Kur u shpallën rezultatet e para, Daut Dauti ishte ulur afër Daan Evertsit, shefit të Misionit të OSBE-së. Gjithë Kosova po e shikonte këtë konferencë për shtyp. Kishte gazeta të shtypura atëbotë, madje disa.
Ishte gara e parë demokratike pas luftës.

Daan Evertsi tha me entuziazëm se, nga sot, 28 tetor 2000, Kosova iu bashkua demokracive të kësaj bote. Dhe këtë pastaj e konfirmoi zëdhënësi Daut Dauti. Ishte zëdhënësi i parë i demokracisë pas vitit 1999.

Ngushëllime të gjithë atyre që ishin pjesë e rrugëtimit në këtë botë të Daut Dautit. Sidomos ngushëllime familjes së tij në Londër, në Gjilan dhe në Kokaj, vendlindjen e tij, të cilën nuk e harroi kurrë.

Tani dhe përherë është përgjegjësi e shoqërisë shqiptare që kontributi dhe vepra e tij të gjejnë vendin e merituar në kujtesën tonë kolektive.

DAUT DAUTI – DËSHMITAR I DENJË I PËRPJEKJEVE TË POPULLIT TË KOSOVËS PËR LIRI, PAVARËSI DHE SHTETËSI

BEJTULLAH DESTANI

Me pikëllim të thellë mora lajmin për ndarjen nga jeta të mikut, intelektualit dhe veprimtarit të shquar, dr. Daut Dauti.

Dauti i përkiste atij brezi të intelektualëve shqiptarë që dijen nuk e konsideronin privilegj vetjak, por përgjegjësi ndaj atdheut.

Ai ishte historian, jurist, gazetar e publicist, por, mbi të gjitha, ishte një njeri i përkushtuar ndaj Kosovës dhe çështjes shqiptare.

Në Londër, Dauti ishte njëri ndër organizatorët e referendumit për pavarësinë e Kosovës, të mbajtur në shtëpinë e Agron Loxhës.

Ishte gjithashtu njëri prej themeluesve të klubit shqiptar "Faik Konica", i cili për vite me radhë shërbeu si vatër e rëndësishme e veprimtarisë kulturore, intelektuale dhe kombëtare të shqiptarëve në Britaninë e Madhe.

Gjatë viteve të rënda të Luftës së Kosovës, më 1998–1999, ai dha një kontribut të jashtëzakonshëm në Londër.

Me fjalën, shkrimin, lidhjet dhe angazhimin e tij të palodhur, Dauti punoi për ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës dhe për paraqitjen e së vërtetës shqiptare përpara opinionit britanik.

Në një kohë kur Kosovës i duhej zëri i çdo shqiptari, ai ishte ndër zërat më të ndërgjegjshëm, më të argumentuar dhe më të përkushtuar.

Daut Dauti i kreu studimet në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, ndërsa studimet pasuniversitare i vazhdoi në Londër.

Në Universitetin e Leedsit përfundoi doktoratën me temën "Politika e jashtme britanike dhe çështja shqiptare 1876–1914", duke sjellë një kontribut të çmuar në studimin e marrëdhënieve shqiptaro-britanike dhe të historisë diplomatike të çështjes shqiptare.



Punimi i tij i doktoratës u botua në gjuhën shqipe në Shkup, ndërsa në gjuhën angleze nga shtëpia botuese "Bloomsbury" në Londër.

Me hulumtimet e tij në arkivat britanikë, Dauti nxori në dritë dokumente dhe dëshmi të rëndësishme, duke e pasuruar historiografinë shqiptare me burime, argumente dhe këndvështrime të reja.

Ai ishte autor i disa librave dhe i një numri të madh studimesh, artikujsh e analizash. Njëri prej librave të tij u promovua në Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Londër nga historiani i shquar britanik, Sir Noel Malcolm.

Dauti e nisi herët rrugën e gazetarisë. Shkroi për "Botën e Re", revistën "Zëri", "Zërin javor" dhe për gazeta të tjera në Kosovë e Shqipëri.

Prej vitit 1994 deri më 1999 ishte korrespondent nga Londra, duke raportuar në një nga periudhat më vendimtare të historisë sonë të re.

Më vonë punoi edhe pranë Institute for War and Peace Reporting dhe kontribuoi në themelimin e zyrës së këtij institucioni në Prishtinë.

Pas luftës, shërbeu si sekretar i Përgjithshëm i Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës.

Në vitin 2005 ishte këshilltar për media dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës, të drejtuar nga kryeministri Bajram Kosumi.
Kudo që punoi, ai solli seriozitetin e studiuesit, përgjegjësinë e gazetarit dhe urtësinë e njeriut që e njihte mirë peshën e fjalës publike.

Në jetën e tij intelektuale dhe profesionale Dauti krijoi miqësi të shumta. Ndër to ishte edhe miqësia me gazetarin dhe njohësin e shquar të Ballkanit, Tim Judah.

Ai dinte të ndërtonte ura ndërmjet njerëzve dhe kulturave, duke e paraqitur çështjen shqiptare me dinjitet, dije dhe argumente të qëndrueshme.

Daut Dauti nuk ishte njeri i zhurmës. Ishte njeri i punës së qetë, i dokumentit, i fjalës së peshuar dhe i përkushtimit të pandërprerë.

Në biseda ishte i dashur dhe i çiltër; në shkrime, i mprehtë dhe i argumentuar; në miqësi, besnik dhe bujar.

Ai e ndante dijen pa kursim dhe gëzohej kur mund t'u vinte në ndihmë të tjerëve.

Dr. Daut Dauti u nda nga jeta në Londër, në mëngjesin e 1 shtatorit 2026, pas një sëmundjeje të rëndë.

Me largimin e tij, familja humbi njeriun e saj të dashur, miqtë humbën një shok besnik, ndërsa kultura, gazetaria dhe historiografia shqiptare humbën një nga punëtorët e tyre të palodhur.

Por njerëzit si Dauti nuk largohen tërësisht. Ata vazhdojnë të jetojnë në librat që kanë shkruar, në dokumentet që kanë zbuluar, në mendimet që kanë nxitur dhe në kujtesën e njerëzve që patën fatin t'i njohin.

Ai do të mbetet pjesë e historisë së veprimtarisë shqiptare në Britaninë e Madhe dhe një dëshmitar i denjë i përpjekjeve të popullit të Kosovës për liri, pavarësi dhe shtetësi.

Familjes Dauti, të afërmve, miqve dhe bashkëpunëtorëve të tij u shpreh ngushëllimet e mia më të sinqerta.

Lamtumirë, miku im Daut.
U prehsh në paqe!
I përjetshëm qoftë kujtimi dhe e paharruar vepra jote!

LAMTUMIRE DAUT!

EMANUEL BAJRA

Me dhimbje të thellë mora lajmin për ndarjen e parakohshme nga jeta të mikut dhe bashkëpunëtorit tim, Daut Dauti.

Na bashkoi gazeta "The Albanian" në Londër, fjala e shkruar dhe përkushtimi ndaj komunitetit shqiptar. Dauti ishte shkrimtar e gazetar me penë të mprehtë, por mbi të gjitha ishte mik i mirë, njeri i urtë dhe një zë i çmuar i shqiptarëve në Britani të Madhe.

Ka njerëz që, kur largohen, nuk lënë vetëm një vend bosh në tryezë.
Lënë një heshtje në bisedat tona, një mungesë në kujtesën e përbashkët dhe shumë fjalë që do të donim t'ua thoshim edhe një herë. Kështu do të më mungojë Dauti.



Pena shqiptare humbi një shkrimtar të vyer, ndërsa komuniteti shqiptar në Londër një prej kronikanëve dhe zërave të tij më besnikë. Unë humba një mik. Lamtumirë, miku im. Fjalët e tua do të mbeten edhe atëherë kur ne të tjerët të kemi heshtur.

Ngushëllimet më të sinqerta familjes, të afërmve dhe të gjithë miqve të tij. U prehsh në paqe, Daut!

IMER A. MUSHKOLAJ

Lajm shumë i hidhur vdekja e Daut Dautit. Me Dautin kam punuar që më 1999 në IWPR dhe në shoqatën e atëhershme të gazetarëve. Kam bashkëpunuar edhe më pas, kur shkurtazi ishte pjesë e institucioneve. Gazetar, studiues e publicist i mirë, intelektual, por mbi të gjitha njeri pozitiv e plot humor.

Para dy vjetësh u takuam në Londër. M'i përmendi problemet shëndetësore me të cilat ballfaqohej, më foli për vendlindjen e tij - fshatin Kokaj të Gjilanit, për shqiptarët e Britanisë dhe ardhjen e tij në Londër, për planet rreth botimit të librave të rinj. Bëmë një shëti nëpër kryeqytetin britanik, që nuk e mendova se do të ishte e fundit me të.

U prehsh në paqe, Daut!

MË TË VARFËR NË GJITHÇKA PA DAUT DAUTIN!

ARBEN MANAJ



Daut Dauti, akademiku, publicisti, historiani nga Kosova, dhe njeriu i mire e i kendshem, vetem nje gje kishte te perseritshme; emrin dhe mbiemrin!
Per gjithshka tjeter ishte i paperseritshem!

Dhe pikerisht ketu qendron humbja ose ameshimi i nje personaliteti si Daut Dauti, mikut, shokut dhe kolegut te nderuar, i cili me largimin nga kjo bote, dhe shikimin qe na ben nga lart, e ben me te rende humbjen e tij fizike dhe me te munguar mospranine e tij njerezore dhe intelektuale!

Me Dautin ishim miq te hershem dhe te kendshem, te harreshem dhe intelektualisht kompatibel!
Me mrekullonte sensi i tij i humorit dhe sarkazmes , jo te mprehur vetem nga te jetuarit ne Britani, por dhe thellesia e gjykimit dhe realizmi i interpretimit te rrethanave politike dhe shoqerore ne pergjithesi ne boten shqiptare, me theks te vecante kur flisnim per Kosoven dhe ish-Jugosllavine!
Dauti ishte "enciklopedi britanike" per keto tema, ashtu sic ishte "arkiv britanik", per detajet e marredhenieve jo vetem te hershme por edhe aktuale britaniko-shqiptare, per te cilat ai ka shkruar libra dhe ka lene nje trashegimi tejet te vyer per shqiptaret e sotem dhe ata qe do vine, e qe do kene interesa me te gjera sesa banalitetet e post-modernizmit!

Takoheshim shpesh me kolege e miq gazetar ketu ne Londer e neper darka a pije neper pub-e, si tek ai i babit te Rita Ores, Besnikut, ku ushqimi dhe pija kalonte ne plan te dyte, pasiqe bisedat per filozofine, politiken, Ballkanin, Kosoven, Shqiperine e Britanine, mernin nje dimension tjeter!

Dauti, kishte nje te kaluar mbreslenese dhe pervoja te ralla nga Kosova, ish-Jugosllavia, Maqedonia dhe te linte pa ngrene me rrefenjat dhe interpretimin e zhvillimeve qe per mua si "i Shqiperise", ishte nje rikthim ne auditoret e informimit!

Daut Dauti ose sic beni hajgare me emrin e tij, Dejvid Dejvid, kishte nje energji te paimagjinueshme dhe deshire te madhe per te jetuar dhe shijuar me te mirat e kesaj bote, edhe pse na ngeli vetem projekt shkuarja ne Nish, andaj edhe udhetonte brenda mundesive te tij, madje edhe jashte tyre, me sakrifice per te pare boten nga e cila u shkeput sot drejt nje bote me te paqme, ku per ate qe ishte si njeri dhe intelektual, pamedyshje, do kete nje vend te privilegjuar ne parajse!

Nuk harroj para dy vjetesh mbremjen e 60 vjetorit te Ditelindjes time, harene dhe kercimin non-stop te tij deri ne fund, sikur perjetonte preludin e asaj qe do i ndodhte me shendetin!

Daut Dauti ishte nje intelektual par excellence, nje njeri i bukur i kesaj bote, qe na beri nder dhe na privilegjoj ne qe e njohem dhe jetuam kohen e tij,e cila do e arkivoj emrin e tij, si jo te cdokujt, ne perjetesi!

Ai rikthet ne Kosoven qe i dhimbte dhe e donte pa mase, dhe i takon Kosoves, ta perjetesoj, sic punoi ai me mish e me shpirt, per ta promovuar dhe ngritur lart Kosoven!

Bota shqiptare, nga sot eshte me pak, jo aq e bukur, pa edhe sa ishte, kur Daut Dauti ishte i gjalle fizikisht mes nesh, e qe na "tradhetoj" me ikjen drejt Atij, qe i perkasim dhe i rikthehemi, shpesh sic ndodh me me te miret; pa rradhen e duhur!

IKJA E HESHTUR E DAUT DAUTIT, KRONISTIT TË LONDRËS QË MBETI AMBASADORI I PASHPALLUR I KOSOVËS !

EMIN AZEMI



Para pak ditësh, saktësisht më 22 gusht, ekrani i telefonit tim u ndez nga një mesazh që mbante peshën e asaj që po vinte. "Tung Emin, sipas mjekëve nuk jam mirë," më shkruante ai me atë qetësinë e tij karakteristike. "Sipas tyre më kanë mbetur disa javë ose disa muaj. Unë po vazhdoj me të vjetrën dhe nuk po vërej ndonjë ndryshim. Ta shohim. Të fala."

Ishte një mesazh ku dinjiteti njerëzor sfidonte parashikimin e zymtë mjekësor.

Por sot, kur mora lajmin e trishtë për shuarjen e tij, kuptova se fati nuk pati durim as për ato "disa javë" e as për ato "disa muaj" që na premtoi shpresa. Betejën me sëmundjen e rëndë e paska humbur miku im i dashur, Daut Dauti.

Është prej atyre lajmeve që njeriu, me një refuzim instinktiv, do të donte me gjithë shpirt të ishte i rremë... Por jo... Kësaj radhe doli ndryshe, mizorisht ndryshe.

Përtej miqësisë së shtrenjtë, Dauti përfaqësonte një institucion më vete në Londrën ku punonte dhe banonte prej dekadash.Një studiues i rrallë, jashtëzakonisht serioz dhe një ambasador i vërtetë, ndonëse jozyrtar, i çështjes së Kosovës në Mbretërinë e Bashkuar. Me Dautin na lidhi një miqësi e pastër, e kalitur nëpër momente të paharrueshme intelektuale e njerëzore. Humbja e tij e papritur më ka tronditur thellë, duke më përballur me vdekshmërinë tonë dhe me vetëdijen e zymtë se bota sapo u bë më e varfër për një mendje të papërsëritshme.

Në vend të një lamtumire të fundit që nuk arritëm ta shkëmbejmë dot fizikisht, mua më mbetet një trashëgimi e shenjtë: dy librat e tij të fundit ("Nëpër gjethe kuijtimesh" dhe "Dilema të pambyllura"), të cilat arrita t'ia botoj dhe të cilat tash më janë edhe në duart e lexuesve.
Ato faqe përmbledhin një punë disa vjeçare publicistike e letrare, një kronikë unike e jetuar dhe e rrëfyer me nota të larta përgjegjësie intelektuale e kreativiteti.

Dauti ishte një kronist i shkathtë dhe i mprehtë i jetës politike, kulturore e diplomatike britanike. Për disa dekada, përmes shkrimeve të tij në mediat e Kosovës dhe librave të tij autorialë, ai u bë ura më e fuqishme lidhëse mes Prishtinës dhe Londrës. E megjithatë, mbetet një peng institucional: Prishtinës zyrtare nuk do t'i falet kurrë që nuk e emëroi Dautin ambasador fuqiplotë në Londër. Sepse më mirë se ai, më me dinjitet dhe më me mençuri se ai, askush tjetër nuk ka ditur ta përfaqësojë Kosovën në analet politike e diplomatike britanike.

Sa herë vinte në Kosovë, kishte dëshirë të më takojë. Shkupin e deshte shumë dhe sa herë takoheshim më fliste edhe për fshatine tij të lindjes, Kokaj , në Karadak të Gjilanit. Disa nga kujtimet tij për këtë fshat i derdhi në formë fabulash letrare në librin e posabotuar "Nëpër gjethe kujtimesh", ku Dauti pikturoi me ngjyrat e fëmijërisë dhe rinisë pejsazhin e fshatit të tij dhe portretizoi bashkfshatarët e tij me vija shumë kreative çehoviane....

Dauti ka vizituar shumë vende të botës, dhe prej andej ka sjellë reportazhe e kronika që do të mbeten si gurë kilometrikë që do të vazhdojnë të masin inelektualitetin e tij... Ai shkroi edhe një roman për Japoninë dhe kur e lexova u mahnita, ndonëse nuk më kujtohej se Dauti kishte qenë ndonjë herë në Japoni.

Doli e vërtetë, ai nuk kishte shkelur kurrë në këtë shtet, por romanin e kishte shkruar me një vërtetëdi të përkrkyer sa nuk të linte fije dyshimi se ai nuk e kishte vizituar Japoninë. Ky ishte Daut Dauti, kronisti i historisë, diplomacisë dhe kulturës, që do të na mjungojë shumë.....

Lamtumirë, miku im i shtrenjtë, udhëto i qetë drejt amshimit ku shpirtrat e ndritur gjejnë paqen e merituar. Librat që lamë pas dhe kujtimi i bisedave tona do të mbeten dëshmitarët e fundit të një miqësie që nuk do ta tresë as harresa e as koha...

I LEHTË TË QOFTË DHEU I VENDLINDJES QË AQ SHUMË E DESHE DR DAUT DAUTI



ISMET AZIZI

Sot mora një nga lajmet më të rënda që mund të merrja.
Në orët e hershme të mëngjesit ndërroi jetë kushëriri im i dashur, miku dhe bashkëpunëtori im shumëvjeçar, historiani, gazetari dhe studiuesi Dr. Daut Dauti.
E dija se prej rreth dy vitesh po përballej me një sëmundje të rëndë dhe të pashërueshme. E dija se po trajtohej në një nga spitalet më të njohura në Londër dhe se mjekësia po bënte gjithçka që ishte e mundur. Por, megjithatë, njeriu deri në fund shpreson.
Sot ajo shpresë u shua.

Për mua, Dauti nuk ishte vetëm një emër i njohur i gazetarisë dhe historiografisë shqiptare. Ishte kushëriri im, miku im, njeriu me të cilin kam ndarë shumë biseda, ide, shqetësime, kërkime dhe projekte. Ishte një bashkëpunëtor tek i cili mund të mbështeteshe gjithmonë.

Humbja e tij është, prandaj, thellësisht personale.
Por ajo është njëkohësisht edhe humbje e madhe për jetën intelektuale shqiptare.

Daut Dauti u lind në vitin 1960 në Kokaj të Gjilanit. Shkollën fillore e kreu në Prishtinë, ndërsa gjimnazin në Gjilan. Studioi në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës dhe më pas vazhdoi studimet pasuniversitare në Londër, në Thames Valley University.
Që herët iu përkushtua gazetarisë. Shkrimet e para i botoi në "Bota e Re", më pas në revistën "Zëri", ku nga viti 1994 deri më 1999 ishte korrespondent nga Londra.

Në vitet e luftës dhe të pasluftës, Dauti ishte një nga zërat e rëndësishëm shqiptarë në Britani të Madhe.
Punoi në Institute for War and Peace Reporting – IWPR, ku kontribuoi edhe në themelimin e zyrës së këtij instituti në Prishtinë.
Ishte Sekretar iPërgjithshëm i Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës, anëtar i pavarur i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, studiues në Kettering Foundation në SHBA, këshilltar për media dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës, si dhe bashkëpunëtor i institucioneve të ndryshme ndërkombëtare.

Por pasioni i tij i madh mbeti historia.
Në University of Leeds, në Shkollën e Historisë, ai u mor me një nga temat më të rëndësishme të historisë sonë kombëtare – politikën e jashtme britanike dhe çështjen shqiptare.
Disertacioni i tij:

"The British Foreign Policy and the Albanian Question 1876–1914"
ishte rezultat i shumë viteve punë në arkivat britanike dhe përfaqëson një kontribut me vlerë të veçantë për historiografinë shqiptare.

Nga kjo punë kërkimore dolën edhe studime e libra të rëndësishëm, ndër të cilët veçoj veprën "Çështja shqiptare në diplomacinë britanike, 1877–1880", një libër që solli dokumente dhe interpretime të rëndësishme për periudhën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe për mënyrën se si Fuqitë e Mëdha e shihnin çështjen shqiptare.

Dauti ishte autor edhe i librave "Reflektime Shqiptaro-Britanike", "Lufta për Trepçën", "Unioni Evropian – Nga Ideja në Realitet", si dhe i shumë studimeve, artikujve dhe analizave të botuara në Kosovë dhe jashtë saj.
Ai kishte një tipar që e çmoja veçanërisht: kërkonte dokumentin.

Nuk kënaqej me përsëritjen e asaj që ishte thënë më parë. Kërkonte burimin, arkivin, dëshminë. Për historinë shqiptare, sidomos për marrëdhëniet shqiptaro-britanike dhe diplomacinë evropiane të shekullit XIX, ai la pas një punë që do të mbetet referencë edhe për brezat e ardhshëm të studiuesve.

Por krahas historianit, studiuesit dhe gazetarit, Dauti kishte edhe një botë tjetër – shumë më intime.
Ajo ishte Kokaj.

Edhe pse jetoi gjatë në Londër, edhe pse rrugët profesionale e çuan në shumë vende të botës, mendja dhe zemra e tij ktheheshin vazhdimisht te vendlindja.

Këtë vit, sikur ta kishte ndier se koha po bëhej gjithnjë e më e çmuar, botoi librin "Nëpër gjethe kujtimesh".

Në kopertinën e këtij libri është shtëpia e tij e lindjes.

Nuk besoj se mund të gjendet simbolikë më e fuqishme.
Pas gjithë atyre viteve të kaluara në Londër, pas arkivave, universiteteve, gazetarisë, diplomacisë dhe debateve të mëdha politike, Dauti u kthye në libër te shtëpia, te fëmijëria, te njerëzit dhe kujtimet e Kokajt.

Sot, përfundimisht, po kthehet te ajo tokë.

Varrimi i tij do të bëhet në Kokaj, në vendlindjen që e deshi aq shumë.
Dauti pas vetes la bashkëshorten, vajzën, dy djemtë, një nip dhe dy mbesa.
Atyre u shpreh ngushëllimet më të thella, duke e ditur se asnjë fjalë nuk mund ta lehtësojë dhimbjen e humbjes së bashkëshortit, babait dhe gjyshit të tyre.

Ngushëllime edhe gjithë familjes Dauti, miqve, kolegëve, gazetarëve, historianëve dhe të gjithë atyre që e njohën dhe e çmuan.

Për mua do të mbetet gjithmonë Dauti që njihja: i qetë, i ditur, racional, i gatshëm për bisedë, për këshillë dhe për bashkëpunim.

Do të më mungojnë bisedat tona.
Do të më mungojë mendimi yt, Daut.
Do të më mungojë ai zëri yt i matur, sidomos kur flisnim për histori, për Kosovën, për shqiptarët dhe për punët që ende duhej t'i bënim.
Por ajo që ke shkruar nuk do të humbasë.

Librat mbesin.
Dokumentet që nxore nga arkivat mbesin.
Idetë mbesin.
Kujtimet mbesin.
Dhe mbi të gjitha, mbetet emri yt mes njerëzve që jetën e tyre ia kushtuan dijes dhe vendit të tyre.
Lamtumirë, kushëriri im.
Lamtumirë, miku im.
Lamtumirë, bashkëpunëtori im i dashur.

Një nga kujtimet që do ta mbaj gjithmonë me vete është udhëtimi ynë i fundit të bashku.
Me kërkesën e Dautit vizituam Tropojën, Luginën e Valbonës, Bajram Currin, Krumën e Hasit dhe Kukësin. Ishte një udhëtim i qetë, mes natyrës, historisë dhe bisedave tona të zakonshme për shqiptarët, për vendin, për librat dhe për kujtesën.
Atëherë nuk e dija se do të ishte udhëtimi ynë i fundit.
Sot, kur i rikthehem atyre ditëve, çdo ndalesë, çdo rrugë dhe çdo bisedë merr një peshë tjetër. Më duket sikur ai udhëtim ishte një lamtumirë e pathënë.
Dauti deshi t'i shihte edhe një herë ato vise. Deshi Valbonën, Tropojën, Hasin dhe Kukësin. Dhe unë pata fatin të jem pranë tij në atë udhëtim.
Sot më ka mbetur kujtimi.
Një kujtim që dhemb, por që njëkohësisht do ta ruaj si një nga dhuratat më të çmuara të miqësisë sonë.
Ishte udhëtimi ynë i fundit, Daut.
Por kujtimi i tij do të udhëtojë me mua gjithmonë.
U prehsh në paqe në Kokajn tënd.
I lehtë të qoftë dheu i vendlindjes që aq shumë e deshe.

DAUT DAUTI KALOI NË PËRJETËSI

AGRON SHALA



E nderuara familje Dauti, familjarë dhe miq të Daut Dautit,

Ngushëllimet e mia më të sinqerta për të gjithë ju që e njohët dhe e deshët Dautin.

Kur miku Ismet Azizi më tha se më keni zgjedhur të flas, i tregova se nuk do ta kisha të lehtë të shprehem, sepse nuk e kam pranuar lehtë largimin nga kjo botë të mikut tim të çmuar. Thjesht, nuk e kam të lehtë të flas për Dautin në kohën e shkuar. Por, i jam mirënjohës për kurajën që më dha për të gjetur forcën të shkruaja ca fjalë, si mik dhe si koleg i Daut Dautit.

Sa herë që Dauti ka qenë në Kosovë, jemi takuar. Në Prishtinë, shtëpia ime ishte edhe shtëpia e tij. Çdo takim e shënonim me një foto dhe një postim. Kur kthehej në Angli, vazhdonin bisedat që i kishim lënë në gjysmë - për libra, filma, muzikë, duke kërkuar këshilla prej tij për librat që shkruaja. Më 21 gusht të këtij viti më uroi për finalizimin e librit tim të ri, ku ai është redaktor. Ndërsa, bisedën e fundit me të e pata më 27 gusht. Më tha: "Mirë jam, si përherë".

Jam njohur me shkrimet e Dautit përmes javores "Zëri". Ai ishte korrespondent nga Londra.
Shkrimet e tij ishin të veçanta. Sepse, jo vetëm që raportonte për zhvillimet që kanë të bëjnë me shqiptarët në Angli, jo vetëm që trajtonte dosjet historike për të kaluarën e shqiptarëve, por shkruante edhe për politikën britanike karshi Kosovës dhe për zhvillimet në vetë Mbretërinë e Bashkuar - duke udhëtuar deri në Belfast për të takuar, për shembull, krerët e Sinn Féin, apo duke intervistuar profesorë e studiues.

Në vitin 1999 jemi takuar në redaksinë e "Zërit" dhe shpejt krijuam një miqësi. Ishte pozitiv, i ngrohtë, me humor të veçantë e të këndshëm. Të gjithë i bënte për vete. Bisedat me të nuk kishin të sosur. Në çdo ndejë mësoja diçka të re prej tij. Isha i lumtur që e njoha, sepse i doja shkrimet e tij. Por, mbi të gjitha, isha i lumtur sepse u bëmë miq të mirë.

Kur Dauti u kthye më 1999 nga Anglia, u angazhua në Institutin për Raportimin e Luftës dhe Paqes, ndërkohë që po ashtu angazhohej për formimin e Shoqatës së parë të Gazetarëve të Kosovës së pasluftës dhe për themelimin e agjencisë së lajmeve Kosovalive.

Bënte punë shumë të vlefshme, meqë kishte për qëllim avancimin e mjedisit mediatik dhe të diskursit publik në vendin tonë.

Në këtë aspekt, ai ka dhënë kontribut edhe me librin "Ngritja e mediave të pavarura në Kosovë", botuar në shqip dhe anglisht në vitin 2002, në bashkëpunim me Fondacionin Kettering në Dejton të ShBA-së.

Pas luftës në Kosovë, Dauti ishte një pikë e rëndësishme orientimi për shumë gazetarë e studiues të huaj që merreshin me Kosovën. Ndërkohë, vazhdoi angazhimin e tij si gazetar në javoren "Zëri", me shkrime analitike, intervista, por edhe reagime që hidhnin poshtë raportimet tendencioze që i bënin disa gazetarë të huaj për realitetin e ri të Kosovës së pasluftës. Ato reagime ishin të vlefshme, sepse përktheheshin edhe në gjuhën angleze. Ndërsa, teksti i nënshkruar nga Daut Dauti kishte peshë.

Dauti ishte gazetar i guximshëm dhe i dijshëm. I përgatitur për çdo debat, për të mbrojtur çdo kauzë të drejtë. Këtë e dinë ata që e kanë parë apo e kanë lexuar në mediat kryesore britanike gjatë luftës në Kosovë, por edhe në debatin e organizuar nga gazetari i njohur i BBC-së, Allan Little, pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

Të pranishëm në këtë debat ishin edhe Misha Glenny e Nebojsha Vlladisavleviq, por edhe miku i tij, Tim Judah.

Kur Glenny tha se pavarësia e Kosovës nuk ofron zgjidhje për problemin, Dauti ia ktheu: "Nuk kishte zgjidhje tjetër, pos pavarësisë. Kishte një zgjidhje tjetër ta kthenim vendin te Serbia, aty ku Misha Glenny dhe disa të tjerë duan ...
Por, kjo zgjidhje tjetër nënkupton ta kthejmë popullin e Kosovës te kasapi, për çfarë bota demokratike mori vendimin e duhur duke e njohur Kosovën". Ai e detyroi Glennyn të thoshte: "Nuk them
se Kosova i takon Serbisë"!

Mbaj mend kur, në prag të zgjedhjeve të para lokale në Kosovë në vitin 2000 - në atë kohë Dauti ka qenë edhe anëtar i pavarur i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, atëherë organ i OSBE-së - organizoi një takim të gazetarëve të Kosovës me gazetarë të huaj dhe me ushtarakë të KFOR-it. Në atë takim shkova unë me kolegun e "Zërit", Halil Matoshin, i cili disa muaj më parë ishte liruar nga burgu.

Kërkesa e Dautit ishte kjo: "Mos bisedoni për politikë, vetëm për të ardhmen". Përballë nesh ishte një gazetare gjermane dhe një ushtarak i Ukrainës.

Ushtaraku ishte i matur, ndërsa gazetarja gjermane vazhdimisht provokonte me qëndrime antishqiptare. Për hir të Dautit, u mundova të ruaja qetësinë e t'ia bëja me dije se është e njëanshme dhe tendencioze.

Por, Halili, për të cilin përktheja, shpërtheu pasi ajo, neglizhente ndaj vuajtjeve të shqiptarëve, i tha se shqiptarët janë ata që duhet t'u kërkojnë falje serbëve. Dauti, si organizator, përkundër këshillës që na dha, nuk mundi të duronte. U ul pranë nesh, u kyç në atë debat të rreptë dhe ajo gazetare pastaj heshti.

I ceka këto për të treguar se Dauti nuk ishte njeri që nënshtrohej apo bënte kompromis me të keqen për ndonjë interes.

Para se të shkonte për hulumtime në Dejton, më ftoi të dilnim për drekë, por paraprakisht t'i vizitonim zyrat e tij, meqë kishte ca punë të vogla: njërën e kishte në Rilindje, tjetrën në Grand dhe një tjetër në objektin e OSBE-së.

Të gjitha opsionet i kishte të hapura. Kishte karrierë, kishte përvojë, kishte dije dhe kulturë. Mund të zgjidhte çfarëdo pune.

Por, si gazetar dhe studiues që kërkon dijen dhe të vërtetën, ai nuk ndihej mirë përballë të padrejtës dhe injorancës. Nuk mund të pajtohej as me të keqen më të vogël.

Kështu, iu kthye punës shkencore dhe qëndrimit në Londër, i qetë pranë familjes, duke na nderuar të gjithë neve me punime shkencore në shtëpitë prestigjioze botuese, si Palgrave apo Taschen, e sidomos me librin "Britania dhe çështja shqiptare gjatë rënies së Perandorisë Osmane, 1876-1914", që ishte temë e doktoratës së tij, botuar nga Bloomsbury.

Isha i lumtur kur botoheshin recensionet pozitive për këtë libër, në revistat prestigjioze të botës.

I përktheja me kënaqësi në shqip dhe i publikoja në portalin Telegrafi, ku ne kemi vazhduar bashkëpunimin tonë. Në këtë portal sot janë 311 shkrime të vlefshme nga Dauti dhe për Dautin. Janë opinione politike, kritika, udhëpërshkrime, kujtime, analiza, studime ...

Isha po ashtu i lumtur kur u angazhova si redaktor i librit "Nëpër gjethe kujtimesh".
Ishim në kontakt të vazhdueshëm. Kënaqesha me çdo tregim të tij, sepse talenti i Dautit për rrëfimtari ishte i pashoq. Për t'u xhelozuar.

Teksa shkruaja parathënien, i thashë: "Miku im, nuk e kam të lehtë të shkruaj, sepse është libër i veçantë, çdo pjesë e tij, prandaj e kam të vështirë të përcaktohem për citate apo ndonjë pjesë të caktuar.
Është libër i rrallë që krijon imazhe në mendje. Sikur vetëm ta kishim një regjisor që do të dinte t'i përkthente ato në film".

Kur e them këtë, më duhet të shtoj se ndihem mirë për shkrimet e shumta që kolegët gazetarë kanë bërë për Dautin. Një pjesë e madhe e tyre kanë përmendur momente të këndshme e plot humor me të.

Momente të tilla kemi të gjithë ne që patëm fatin ta njohim, por mendoj se është e vështirë të përmend këtu ndonjë të tillë, sepse pakkush si ai ka dhuntinë për të rrëfyer, për të zbërthyer fenomenet dhe për t'i kthyer në humor edhe ngjarjet më të pazakonta. Siç e thashë, kur ai fliste, krijonte edhe imazhe.

Por, meqë e donte artin, unë e kam përkthyer për të një poezi të poetit të njohur Robert Burns, me titull: "Epitaf për mikun tim"

Këtu prehet një njeri i ndershëm,
Si rrallëkush që Zoti bekoi me shëmbëlltyrën e Tij:

Mik i njeriut, mik i së vërtetës;
Mik i pleqërisë dhe udhërrëfyes i rinisë:
Pak zemra si e tija, të ngrohta me virtyt,
Pak koka të mbushura me aq dituri:
Nëse ka një botë tjetër, ai jeton në lumturi;

Nëse nuk ka, ai nxori më të mirën nga kjo.
Lamtumirë, mik i nderuar! Do të jemi gjithmonë mirënjohës për gjithçka që ke bërë.
Shpirti yt pushoftë në paqe dhe kujtimi yt qoftë përjetë i bekuar!

DAUT DAUTI – PENA QË KRONIKOI DITËT E VËSHTIRA TË KOSOVËS

SHABAN MAXHARRAJ

Gazetari, historiani e studiuesi Daut Dauti ka vdekur të martën në mëngjes në Britani të Madhe. Lajmin për vdekjen e tij e ka dhënë familja Dauti. Ai ishte 66 vjeç. Veprimtaria e Dautit është përshkruar si ajo e një intelektuali që, si gazetar e studies, ka dhënë kontribut të çmueshëm në afirmimin e çështjes së Kosovës.

Daut Dauti, i lindur më 29 gusht 1960, në karrierën e tij është njohur si gazetar dhe historian. Ishte po ashtu jurist. Ka doktoruar në Universitetin e Leedsit me temën "Politika e jashtme britanike dhe çështja shqiptare 1876–1914".

Paraprakisht, pas përfundimit të Fakultetit Juridik në Prishtinë, ai kishte punuar gazetar në "Bota e Re" e "Zëri". Prej vitit 1994 deri më 1999 ka raportuar nga Londra si korrespondent i "Zërit", dhe prej vitit 1998 ka punuar si gazetar dhe redaktor në IWPR (Instituti për Raportime të Luftës dhe Paqes) në Londër. Qe themelues i kësaj zyre në Kosovë.



Pas luftës, gjatë vitit 2004, ishte zëdhënës i Qeverisë së Kosovës. Më pas konsulent për media në IOM (Organizata Ndërkombëtare për Migrim) në Londër. Si studies njihet për punimet "Si të ndërtohen mediat e pavarura në Kosovë", "Kuvendimi sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit" e "Procesi i lashtë i vendimmarrjes në mesin e shqiptarëve".

Familjes Dauti të martën me një telegram ngushëllimi i është drejtuar Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës. Sipas telegramit, Dauti la pas një veprimtari të pasur profesionale dhe intelektuale.

"Krahas gazetarisë, Dauti dha kontribut të rëndësishëm edhe në publicistikë, historiografi dhe studime, duke lënë pas libra, analiza dhe punime që trajtojnë Kosovën, çështjen shqiptare, mediat dhe marrëdhëniet shqiptaro-britanike. Veprimtaria e tij profesionale, e zhvilluar mes Kosovës dhe Britanisë së Madhe, përbën një pjesë të vlefshme të trashëgimisë së gazetarisë dhe mendimit publik shqiptar", shkruhet në telegram.

Dauti është kujtuar nga kolegë gazetarë në Kosovë. Gazetari e publicisti Halil Matoshi e ka kujtuar se gazetar, autor dhe mik me të cilin kanë punuar bashkë në "Zëri", siç ka thënë ai, në vitet e stuhishme të Kosovës.

"Gazetar, i pasionuar pas historisë. Kemi bërë disa polemika rreth nacionalizmit defansiv shqiptar dhe nacionalizmit të ri që po lindte e po rritej me moshën e shtetit Kosovar, por duke ruajtur ndershmërisht miqësinë e vjetër e baraspeshimin e fjalës", ka shkruar Matoshi.

E, studiuesi Bejtullah Destani, me një shkrim përkujtues, Dautin e ka përshkruar si njeri që i përkiste atij brezi të intelektualëve shqiptarë që dijen nuk e konsideronin privilegj vetjak, por përgjegjësi ndaj atdheut. Për Destanin, mbi të gjitha, ishte një njeri i përkushtuar ndaj Kosovës dhe çështjes shqiptare.

Ka treguar se në Londër, Dauti ishte njëri ndër organizatorët e referendumit për pavarësinë e Kosovës, të mbajtur në shtëpinë e Agron Loxhës.

"Gjatë viteve të rënda të Luftës së Kosovës, më 1998–1999, ai dha një kontribut të jashtëzakonshëm në Londër. Me fjalën, shkrimin, lidhjet dhe angazhimin e tij të palodhur, Dauti punoi për ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës dhe për paraqitjen e së vërtetës shqiptare përpara opinionit britanik.

Në një kohë kur Kosovës i duhej zëri i çdo shqiptari, ai ishte ndër zërat më të ndërgjegjshëm, më të argumentuar dhe më të përkushtuar", ka shkruar Destani. Sipas tij, doktorata e Dautit ka sjellë një kontribut të çmuar në studimin e marrëdhënieve shqiptaro-britanike dhe të historisë diplomatike të çështjes shqiptare. Ka treguar se punimi i tij i doktoratës u botua në gjuhën shqipe në Shkup, ndërsa në gjuhën angleze nga shtëpia botuese "Bloomsbury" në Londër.

"Me hulumtimet e tij në arkivat britanikë, Dauti nxori në dritë dokumente dhe dëshmi të rëndësishme, duke e pasuruar historiografinë shqiptare me burime, argumente dhe këndvështrime të reja", ka shkruar Destani.

Gazetari e redaktori Agron Shala, Dautin e ka përshkruar si një njeri të veçantë, intelektual, me humor të mirë dhe me një pozitivitet që rrezatonte.

"Prandaj, asnjëherë nuk pata me të asnjë konflikt, asnjë mospajtim. Sepse ishte i matur e human dhe njëkohësisht i guximshëm, njeri që nuk i thyente parimet. Kosovën e nderoi jo vetëm gjatë paraqitjeve në televizionet britanike në kohën e luftës, por edhe me veprat e botuara nga shtëpi botuese të njohura si 'Bloomsbury', 'Palgrave' apo 'Taschen'. Ai e jepte kontributin e vet pa kërkuar asnjë kompensim", ka shkruar Shala. Ka rrëfyer se bashkë kanë biseduar shpesh, deri në javën e fundit.

"Sa herë që vinte në Kosovë, takoheshim. Besoja se do të takoheshim sërish, t'ia dhuroja pjesën e dytë të librit 'Shekulli XX', që tashmë ka dalë nga shtypi dhe ku ai është redaktor", ka shkruar Shala.

Në njoftimin e familjes është bërë me dije se për detajet e ceremonisë së varrimit do të tregohet më vonë, pasi fillimisht duhet të organizohen procedurat e bartjes së kufomës për në Kosovë.

PREHU NË PAQE, BURRË I URTË

ARBER RAMADANI

"Daut Dauti ka qenë ndoshta intelektuali i vetëm nga Anamorava. Ironikisht, Dauti më ka dërgu ftesë miqësie në Facebook, vite më parë, ndoshta në vitin 2015 ose 2016, pas një shkrimi tim në mediat lokale me titull, 'Qyteti pa intelektual'.

Kisha lexuar pak për Dautin dhe nga Dauti, para se të ishim shokë në rrjete sociale, por nga atëherë, secilin shkrim të tij e kam lexuar me kureshtje.

Dauti ishte burrë i urtë në të gjitha kuptimet e kësaj fjale.

Para pak vitesh, ndoshta vitin e kaluar, e pashë rastësisht te Hotel Kristal në Gjilan. Nuk isha i sigurt nëse më njihte, anipse shpeshherë më konfirmonte shkrimet e mia me 'like' ose më rrallë me komente të ndërsjella.

Ngurrova, dhe e shmanga shikimin.

Pak sekonda para se të largohesha nga aty, më thirri në emër, më përshëndeti dhe më përgëzoi për angazhimin. Më tha se po e priste dikë me të cilin kishte lënë takim, por se do të takoheshim për të qëndruar më gjatë njëherë tjetër.

Dauti ka qenë prej pak njerëzve me të cilin do të doja të qëndroja pak më gjatë.



E kam respektuar siç respektoj pak njerëz.

Prehu në paqe burrë i urtë!"

FATMIR ISMAJLI

"Sot zemra na është mbushur me dhimbje dhe është shumë e vështirë të gjejmë fjalët për ta shprehur atë që ndiejmë.

Sot u nda nga jeta dhëndri im, Daut Dauti.

Dauti nuk ishte vetëm burri i motrës sime. Ai ishte bërë pjesë e familjes sonë, njeri i afërt, i dashur dhe i respektuar nga të gjithë ne.

Do të na mungojë zëri yt, bisedat me ty, prania jote dhe ajo urtësi që e kishe në fjalët e tua. Do të na mungosh në çdo tubim familjar, në çdo bisedë dhe në çdo ditë që do të vijë.

Ti ike nga kjo botë, por nuk do të ikësh kurrë nga kujtimet dhe zemrat tona.

Ti që gjatë gjithë jetës shkrove për kujtesën, historinë dhe njerëzit, sot po bëhesh vetë një kujtim që ne do ta ruajmë përgjithmonë.

Daut i dashur, faleminderit për çdo fjalë, çdo kujtim dhe çdo moment që ndamë me ty.

U prehsh në paqe, dhëndri im.

Do të na mungosh shumë.

Kujtimi yt qoftë i përjetshëm.

Lamtumirë, Daut!"

UDHËTIMI LAMTUMIRËS I DR. DAUT DAUTI NË MAKONDON E TIJ, NË KOKAJ



EMIN AZEMI

Më 6 shtator, me dhimbje e pikëllim të thellë, i dhamë lamtumirën e fundit Dr. Daut Dautit, i cili ndërroi jetë në Londër më 1 shtator. Teatri i Qytetit të Gjilanit u shndërrua në një tempull të përlotur kujtimesh. Në atë hapësirë plot dritëhije emocionale, miqtë dhe familjarët evokuan me mall e nderim figurën e tij të ndritur.

Në këtë rrugëtim të fundit, tek shihja njerëzit e mbledhur, ndjeva një pezm të lehtë njerëzor për mungesën e heshtur (me përjashtim të tre- katër vetave)të një pjese të kolegëve dhe elitës nga Prishtina. Ishte një keqardhje e hollë që rëndonte në ajër, duke kujtuar atë rreth të gjerë njerëzish që Dauti i çmonte aq shumë e i konsideronte miq të idealit intelektual.

Kjo mungesë e tyre la një shije keqardhjeje, megjithatë shpirti i tij i madh u rrethua nga dashuria e pastër e atyre që e deshën pa kushte.

Më pas, një rrugë gjarpërore na dërgoi te stacioni i fundit ku do të prehet tash e tutje trupi i Dautit, aty në tokën e stërgjyshërve të tij në Kokaj të Gjilanit. Kokaj për Dautin është si Makondo për Markezin.

Një hapësirë mitike, një vatër imagjinare prej nga ai mblodhi zërat, legjendat e frymën e parë të botës së tij krijuese për t'i shndërruar në art të përjetshëm. Aty u ndamë me Dautin vetëm fizikisht, sepse shpirtërisht ai mbetet i rrënjosur mes nesh.

Kujtimi për të do të jetë i amshueshëm, ashtu siç do të jenë të pasosura respekti, konsiderata dhe gjithë dashamirësia ndaj këtij burri që na la me një boshllëk të madh në zemër.

Duke iu bashkangjitur evokimeve të përgjithshme, kujtesa ime për Dautin vjen si një përgjërim shpirtëror për mikun që bëri epokë në heshtje, sepse të flasësh për të në kohën e shkuar mbetet një nga sprovat më të rënda.

Ikja e tij la pas një zbrazëti të ftohtë për familjen që e pati shtyllë shtëpie në udhëkryqet e gjata midis Prishtinës e Londrës, megjithatë kjo zbrazëti ndez dritën e pashterrshme të një shpirti të jashtëzakonshëm.

Dauti shkriu në personalitetin e tij me një mjeshtëri të rrallë historianin, gazetarin dhe shkrimtarin.

Si një kërkues i paepur, ai refuzoi komoditetin e zyrave duke zgjedhur pluhurin e arkivave të vështira britanike, ku zbardhi të vërtetën e patjetërsueshme të kombit tonë dhe bëri që zëri ynë shkencor të dëgjohej i saktë nga Londra në mbarë botën.

Pena e tij e mprehtë ndriçoi kauza të mëdha kombëtare, ndërsa në rrafshin njerëzor ai rrezatoi një thjeshtësi fisnike.

Gjatë muajve të artë në redaksinë e gazetës FAKTI në Shkup, ai nuk e mbajti për vete përvojën perëndimore, por u ul pranë gazetarëve të rinj si mentor e udhërrëfyes i atyre që më vonë bënë emër në Shkup e gjetiu.

Ky njeri i madh ruajti deri në frymën e fundit një lidhje mistike me rrënjët e tij.

Pak para se të ndërronte jetë, ai na la testamentin e tij letrar, librin me tregime "Nëpër gjethe kujtimesh", të cilin pata fatin e madh ta redaktoj e ta botoj bashkë me veprën "Dilema të pambyllura".

Ky mozaik i gjallë autobiografik e mitologjik shpërfaqi shpirtin e tij jashtëzakonisht të ndjeshëm dhe dashurinë e pashuar për njerëzit e gjakut të tij.

Sot, teksa trupi i tij tretet në dheun e Kosovës që e deshi me çdo rrahje zemre, familja e tij mbetet trashëgimtare e një nderi të madh kombëtar.

Dr. Daut Dauti la gjurmë të pashlyeshme në historinë e këtij vendi, prandaj ne, miqtë dhe kolegët e tij, do të jemi gjithmonë roje të kujtimit të tij të ndritur.

FRYMËN E JETËN PREJ HISTORIANI, GAZETARI E STUDIUESI IA KUSHTOI KOSOVËS E ÇASHTJES SHQIPTARE

FJOLLA SPANCA

Kur për s'pari herë u shkrujtem, unë po i përcjellja lutjen teme të 'pa za' që Zakaria, nji ditë me lexue ndën rreshtat e bacës Daut; intelektualit të acikum, të fismit e të mbrumunit me dituni e urtni.

I gzueshëm, baca Daut Dauti m'thotë se, mu në atë dekik, paskësh qenë tuj bisedue me zojen Bukurije Dauti për shkarravitjet e mia, që, sipas tij, qenë të ambla e të thella.

U flakruen faqet.
Ama, n'sytë e mi mbeti gatë emni i Bukuries, të cilin Daut Dauti e vuni para vetes.
Asaj nate, e bamë me llaf' që, së shpejti, kishim me u pa e me ba muhabet gjanë e gjatë.
Besa, ashtu ndodhi: për promovimin e librit të Besnik Mustafaj, Daut Dauti zbarkoi në Tiranë.
Qe shtator; piklat e shiut e kishin mbërthye tanë Tiranën. Prej tarracës së 15-Katëshit, hotelit që shtrohet n'buzë t'mejdanit, e kqyrshim shehrin e bukur të shqiptarisë… Baca Daut kishte nji kërshëri të paepun për Shqipninë dhe donte se s'ban me e njoftun atë edhe përmes syve t'nji shqiptareje prej Kosovës, që kishte shku nuse në nji shpi çamësh të ramë n'Tiranë. fill' u afru me Rezartin tuj e lexue hallin e përvujtninë e shqiptarëve t'përzanë prej Çamërisë.
Durimi për me ngue dhe thellësia e t'pyetunit për me kuptue – ishin nishanet e t'Mirit Daut. Ai, siç shkruente edhe kur fliste ishte i pakompromis me t'vërtetën!
Nji gjysh babaxhan - që nuk u bezdis as edhe për nji moment nga zhurmat, ecejaket, lojëzat e thirrmat e Zakarias, aso kohe veç nji vjeç e pak.
Urtnia që i rrinte sojshëm mbi supe t'bante me e çmue dhe me e respektue, krejt natyrshëm.
Ndonëse kishte emigru shumë herët në Britani, frymën e jetën prej historiani, gazetari e studiuesi ia kushtoi Kosovës e çashtjes shqiptare.
Kthimi i Shpirtit tek Zoti i Tij,
doemos na kujton përkohshmëninë tonë fizike mbi këtë Tokë dhe - përjetësinë e punëve të mira; menimeve të nalta dhe yrnekut të pashoq që Disa e lajnë mrapa ...
U takofshim n'bahce Xheneti, baca Daut!

QINDRA AZILKËRKUES TË KTHYER NGA BRITANIA NË FRANCË JANË ZHDUKUR, MES TYRE EDHE FËMIJË

Sipas organizatave të të drejtave të njeriut, qindra azilkërkues të larguar nga Britania drejt Francës në kuadër të marrëveshjes "një hyn, një del" janë zhdukur pas kthimit. Mes tyre raportohet se janë edhe të paktën 41 të mitur, mosha e të cilëve ishte kontestuar.

Marrëveshja Britani-Francë, e nisur në korrik 2025, parashikon që azilkërkuesit që mbërrijnë në Britani me gomone të kthehen në Francë, në këmbim të personave që zhvendosen ligjërisht nga Franca drejt Britanisë.

Që nga shtatori 2025, rreth 1,400 persona janë kthyer në Francë, ndërsa më shumë se 32,000 kanë kaluar Kanalin Anglez gjatë kësaj periudhe.

Organizatat thonë se disa prej të kthyerve janë zhdukur nga radarët e autoriteteve dhe po jetojnë në mënyrë të fshehtë në vende të ndryshme të Europës, duke iu shmangur autoriteteve franceze dhe frikës nga dëbimi drejt vendeve të tjera.

Një shqetësim i veçantë lidhet me fëmijët e pashoqëruar. Organizatat pretendojnë se të paktën 41 të mitur janë kthyer në Francë, ndërsa autoritetet britanike e mohojnë kategorikisht këtë. Monitorues të pavarur kanë raportuar ndërkohë se afro 100 persona të identifikuar si fëmijë janë mbajtur në mënyrë të paligjshme në ambiente paraburgimi për të rritur.

Mjekët pa Kufij kanë paralajmëruar gjithashtu për gjendjen e rënduar psikologjike të disa azilkërkuesve të kthyer, duke raportuar raste me ankth të rëndë, mendime vetëvrasëse dhe trauma psikologjike.

Marrëveshja pritet të skadojë më 1 tetor 2026, ndërsa qeveria britanike kërkon zgjatjen dhe zgjerimin e saj. Franca, nga ana tjetër, kërkon që skema të shtrihet në nivel europian.



BRITANI: MIJËRA AZILKËRKUES JETOJNË PREJ VITESH NË HOTELE, FAMILJET PËRBALLEN ME KUSHTE TË RËNDA

Më shumë se 16 mijë azilkërkues në Britani ndodheshin ende në hotele në qershor 2026, pavarësisht se këto ambiente ishin parashikuar fillimisht si strehim i përkohshëm.

Sipas The Times, familje me fëmijë kanë kaluar deri në disa vite në dhoma të vogla hoteli, shpesh pa hapësirë të mjaftueshme për të fjetur, studiuar apo luajtur. Një nga rastet e përshkruara është ai i një familjeje që jetoi për tre vjet në një dhomë të destinuar për një person, edhe pasi familja u shtua me lindjen e binjakëve.

Raporte të organizatave humanitare kanë evidentuar gjithashtu probleme me mungesën e kuzhinave, ushqimin, kushtet higjienike dhe sigurinë. Në një hotel raportohet prania e minjve, ndërsa në një tjetër janë denoncuar raste të abuzimit racist nga stafi.

Rasti bëhet edhe më shqetësues për familjet me fëmijë. Disa prej tyre kanë qenë të detyruara të bëjnë detyrat e shkollës në dysheme, ndërsa oraret e vakteve në disa hotele kanë bërë që fëmijët të shkojnë në shkollë pa ngrënë mëngjes.

Home Office thotë se po punon për mbylljen e të gjitha hoteleve të përdorura për azilkërkues dhe se numri i personave të akomoduar në to është ulur me 50% gjatë vitit të fundit.

Deputetët britanikë rrëzojnë për herë të dytë ligjin për vdekjen e asistuar

Deputetët në Britani kanë rrëzuar për herë të dytë një projektligj që synonte legalizimin e vdekjes së asistuar në Angli dhe Uells, pas një debati emocional në Dhomën e Komunave.
Projektligji, i paraqitur këtë herë nga deputetja laburiste Lauren Edwards, u rrëzua me 286 vota kundër dhe 270 pro. Ai parashikonte që të rriturit me një jetëgjatësi të mbetur prej më pak se gjashtë muajsh të mund të kërkonin vdekjen e asistuar, nën disa kushte dhe kontrolle të përcaktuara.

Kjo ishte përpjekja e dytë për të ndryshuar ligjin. Një projektligj i ngjashëm, i mbështetur nga deputetja Kim Leadbeater, kishte kaluar më parë në Dhomën e Komunave, por më pas ngeci në Dhomën e Lordëve pasi u paraqitën një numër i madh amendamentesh dhe parlamenti nuk pati kohë ta përfundonte procesin.

Debati i së premtes u shoqërua me emocione të forta. Mbështetësit argumentuan se personat me sëmundje terminale duhet të kenë të drejtën të zgjedhin mënyrën e fundit të jetës së tyre, ndërsa kundërshtarët shprehën shqetësime për sigurinë, mbrojtjen e personave vulnerabël dhe mungesën e mbështetjes së mjaftueshme në kujdesin paliativ.

Disa deputetë laburistë që votuan kundër deklaruan se projektligji ishte i pasigurt dhe praktikisht i pazbatueshëm. Ata kërkuan që fillimisht të përmirësohen kujdesi paliativ dhe shërbimet sociale.

Pas votimit, mbështetësit e ligjit shprehën zhgënjim, ndërsa kundërshtarët e konsideruan rezultatin një mundësi për t'u përqendruar te përmirësimi i kujdesit për pacientët me sëmundje të rënda.

Me rrëzimin e projektligjit, nuk pritet që vdekja e asistuar të legalizohet në Angli dhe Uells në këtë legjislaturë, megjithëse mbështetësit kanë sinjalizuar se çështja mund të rikthehet në të ardhmen.

BRITANIA DHE BELGJIKA BASHKOHEN KUNDËR TRAFIKANTËVE, GODITET RRJETI I GOMONEVE ME EMIGRANTË DREJT KANALIT

Britania ka arritur një marrëveshje të re me Belgjikën për të goditur rrjetet e trafikantëve që organizojnë kalimet e emigrantëve drejt Britanisë përmes Kanalit Anglez.

Në kuadër të marrëveshjes, policia belge do t'u bashkohet forcave britanike dhe franceze në luftën kundër bandave të kontrabandës së emigrantëve. Gjithashtu, autoritetet e të dyja vendeve do të mund të shkëmbejnë më shpejt informacionet e inteligjencës për aktivitetet kriminale.

Marrëveshja vjen pasi trafikantët dyshohet se kanë zhvendosur një pjesë të aktivitetit drejt Belgjikës, duke përdorur të ashtuquajturat "varka taksi", të cilat lundrojnë përgjatë bregdetit për të marrë emigrantë që synojnë të kalojnë drejt Britanisë.

Policia belge ka evidentuar 32 tentativa të dyshuara për nisje të gomoneve gjatë periudhës janar-prill 2026, krahasuar me vetëm dy gjatë gjithë vitit të kaluar.

Mbi 50 persona të dyshuar për kontrabandë janë arrestuar tashmë në operacionet e përbashkëta britaniko-belge këtë vit, ndërsa janë sekuestruar më shumë se 40 automjete.

Marrëveshja është e para e këtij lloji mes Britanisë dhe një vendi të BE-së që prej Brexit dhe do të shtrihet edhe në luftën kundër rrjeteve që merren me trafikimin e drogës dhe armëve.

Sekretarja britanike e Brendshme, Shabana Mahmood, tha se rrjetet e kontrabandës veprojnë përtej kufijve dhe se Britania do të bashkëpunojë me partnerët ndërkombëtarë për t'i identifikuar dhe çmontuar ato.

RRITJA E INTELIGJENCËS ARTIFICIALE NDIHMON EKONOMINË BRITANIKE TË RRITET PAPRITUR NË KORRIK

Ekonomia e Mbretërisë së Bashkuar u rrit me 0.4% në korrik, duke tejkaluar ndjeshëm pritshmëritë e ekonomistëve, të cilët kishin parashikuar zero rritje.

Sipas Zyrës për Statistikat Kombëtare (ONS), rritja u mbështet kryesisht nga sektori i shërbimeve, veçanërisht nga programimi kompjuterik dhe aktivitetet e lidhura me inteligjencën artificiale.

Drejtoresha e statistikave ekonomike në ONS, Liz McKeown, tha se kishte prova se kompanitë që punojnë me AI dhe teknologji të ngjashme kishin ndihmuar në rritjen e aktivitetit ekonomik jo vetëm gjatë korrikut, por edhe në maj dhe qershor.

Ekonomia britanike ishte rritur me 0.3% në qershor, ndërsa në maj nuk kishte shënuar rritje.
Sipas ONS, në tre muajt deri në korrik ekonomia u rrit me 0.4% krahasuar me tre muajt paraardhës, një tregues që jep një pamje më të qëndrueshme të ecurisë ekonomike.

Megjithatë, ekspertët paralajmërojnë se ritmi i rritjes mund të ngadalësohet në muajt e ardhshëm për shkak të çmimeve të larta të energjisë dhe kostove të huamarrjes.

Ekonomisti kryesor për Mbretërinë e Bashkuar në Capital Economics, Paul Dales, tha se të dhënat e korrikut tregojnë se qëndrueshmëria e ekonomisë në gjysmën e parë të vitit ka vazhduar edhe në fillim të gjysmës së dytë.

Nga ana tjetër, ai paralajmëroi se çmimet më të larta të energjisë dhe kostot e huamarrjes mund të fillojnë të ndikojnë në rritje, veçanërisht nëse rritjet e fundit të çmimeve vazhdojnë.

LEXMARK
LEGAL

DËSHIRONI TË JETONI, PUNONI APO STUDIONI NË MB?

Ne ofrojmë shërbime të specializuara imigrimi, të përshtatura sipas rrethanave tuaja.

Ekipi ynë profesionist ju udhëzon në çdo hap, duke e bërë procesin e imigrimit të qartë, të sigurt dhe pa stres.



SHËRBIMET TONA PËRFSHIJNË:

- Viza për punëtorë të kualifikuar
- Viza studimi
- Viza për bashkëshort dhe familjarë
- Viza Global Talent & Inovative
- Punonjës fetarë
- Vendbanim të përhershëm (ILR)
- Shtetësi britanike
- Apelime dhe rishikime vizash

Ne ju ndihmojmë me këshillim profesional, përgatitje dokumentesh dhe mbështetje të plotë gjatë aplikimit.

Na kontaktoni sot për një të ardhme më të sigurt në Mbretërinë e Bashkuar.
Ekspertë të besuar të imigracionit.

- 07494181220
- 07435119343
- 02080902488

Ashley House 235 - 239
High Road, Wood Green,
London N22 8HF

OKB NGRE SHQETËSIME PËR SISTEMIN E AZILIT NË BRITANI: RREZIK QË MIGRANTËT TË MARRIN STATUS PA PLOTËSUAR KRITERET

Një auditim i agjencisë së OKB-së për refugjatët, UNHCR, ka ngritur shqetësime serioze për mënyrën se si autoritetet britanike shqyrtojnë kërkesat për azil.

Sipas raportit, mangësitë në intervistat e zhvilluara nga Home Office krijojnë rrezik që disa persona të marrin azil edhe kur nuk i plotësojnë kriteret, ndërsa refugjatë që kanë nevojë për mbrojtje mund të refuzohen.

UNHCR shqyrtoi 60 intervista dhe dosje azili. Në afro një të tretën e rasteve të analizuara, baza e plotë e kërkesës së aplikantit mbeti e paqartë edhe pas intervistës.

Raporti evidenton probleme me mënyrën e marrjes në pyetje, duke përfshirë përdorimin e shumë pyetjeve të mbyllura, moshetimin e mjaftueshëm të fakteve kryesore dhe raste kur përkthyesit kanë përmbledhur përgjigjet në vend që t'i përkthenin ato plotësisht.

Sipas të dhënave të Home Office të cituara në raport, vetëm 52% e vendimeve për azil në vitin 2023-2024 përmbushën standardet e cilësisë së vetë institucionit, një nga nivelet më të ulëta të regjistruara.

Raporti paralajmëron se problemet në proces mund të çojnë në dy lloje gabimesh: refuzimin e personave që kanë nevojë realisht për mbrojtje dhe dhënien e azilit personave që nuk i plotësojnë kriteret.



Nga ana tjetër, Home Office ka deklaruar se mirëpret raportin e UNHCR-së dhe se janë bërë përmirësime në trajnimin e punonjësve që marrin vendimet për kërkesat e azilit.

Çështja ka shkaktuar reagime politike në Britani, me opozitën që e ka përdorur raportin për të kritikuar mënyrën se si qeveria po menaxhon sistemin e azilit.

Reform UK "bleu" sondazhe prej 32,500 paundësh, shpërthen skandali për financimin

Partia britanike Reform UK është përfshirë në një skandal lidhur me financimin e sondazheve politike, pasi një investigim i fshehtë ngriti dyshime se partia kishte siguruar sondazhe me vlerë mbi 30 mijë paund, të financuara nga një burim amerikan.

Në qendër të çështjes janë tre sondazhe të kompanisë JL Partners, të cilat u publikuan në media britanike dhe paraqisnin rezultate të favorshme për Reform UK. Sipas investigimit, sondazhet kushtuan rreth 32,500 paund dhe u porositën në interes të partisë.

Problemi lidhet me faktin se ligji britanik vendos kufizime të forta për financimin e partive politike nga burime të huaja. Investigimi i Channel 4 pretendon se zyrtarë të Reform UK diskutuan mënyra për të siguruar financime nga një person në SHBA.

Pas publikimit të pamjeve të regjistruara fshehurazi, dy zyrtarë të lartë të Reform UK, James Orr dhe Dan Jukes, u pezulluan. Partia ka mohuar shkeljen e ligjit dhe ka nisur një hetim të brendshëm.

Ndërkohë, çështja po shqyrtohet nga autoritetet përkatëse britanike, ndërsa JL Partners është vënë nën hetim për dyshimet se nuk kishte bërë të qartë se sondazhet ishin porositur nga Reform UK.

Mbi 2,500 të burgosur do të lirohen para fundit të vitit në Britani

Qeveria britanike ka rishikuar planin për lirimin e parakohshëm të të burgosurve, me synimin për të lehtësuar mbipopullimin e madh në burgjet e Anglisë dhe Uellsit.

Sipas planit të ri, rreth 2,550 të burgosur pritet të lirohen deri në Krishtlindje, në disa faza gjatë muajve tetor, nëntor dhe dhjetor.

Masa ka shkaktuar reagime të forta, veçanërisht nga familjarët e viktimave dhe opozita, të cilët paralajmërojnë për rrezikun ndaj sigurisë publike.

Ndërkohë, qeveria ka sqaruar se kriminelët e dënuar për veprat më të rënda, përfshirë vrasjet dhe disa krime seksuale, do të përjashtohen nga skema.

Vendimi vjen në një kohë kur burgjet britanike po përballen me mungesë serioze kapacitetesh, ndërsa qeveria po kërkon edhe zgjidhje afatgjata për krizën e sistemit penitenciar.

ALARM NË NHS: TRAJNIMI PËR PARANDALIMIN E HUMBJES SË JETËVE PO DËSHTON

Qindra njerëz mund të kenë humbur jetën në mënyrë të parandalueshme për shkak të zbatimit të dobët të trajnimeve të reja për parandalimin e vetëvrasjeve në NHS, ka zbuluar një hetim i The Times.

Më shumë se një vit pasi NHS England prezantoi udhëzimet e reja "Staying Safe From Suicide", më pak se 10% e rreth 150,000 profesionistëve të shëndetit mendor kishin përfunduar trajnimin përkatës, sipas dokumenteve të brendshme të NHS.

Udhëzimet e reja synojnë të ndryshojnë mënyrën se si profesionistët vlerësojnë rrezikun e vetëvrasjes. Në vend që pacientët të klasifikohen thjesht si me rrezik "të ulët", "mesatar" apo "të lartë", rekomandohet një qasje më individuale, e cila merr parasysh gjendjen emocionale të personit, faktorët që mund të shkaktojnë krizë dhe mbështetjen që ai ka rreth vetes.

Ekspertët argumentojnë se vlerësimet tradicionale të rrezikut mund të jenë të pamjaftueshme, pasi mendimet dhe impulset vetëvrasëse mund të ndryshojnë shumë shpejt.

Sipas të dhënave të cituara nga The Times, rreth 30% e më shumë se 7,000 personave që kryejnë vetëvrasje çdo vit në Mbretërinë e Bashkuar kanë qenë në kontakt me shërbimet e shëndetit mendor. Megjithatë, më shumë se 80% e këtyre personave ishin vlerësuar si me rrezik të ulët ose pa rrezik pak para vdekjes së tyre.

Philip Pirie, babai i një djali që humbi jetën nga vetëvrasja dhe bashkëdrejtues i grupit që zhvilloi udhëzimet e reja, e ka cilësuar situatën si "të turpshme". Ai ka kërkuar që trajnimi të bëhet i detyrueshëm për profesionistët e shëndetit mendor.

Edhe ish-sekretari britanik i Shëndetësisë, Sajid Javid, ka mbështetur kërkesën për trajnim të detyrueshëm, duke argumentuar se parandalimi i vetëvrasjeve duhet të jetë një prioritet i NHS.

Shqetësime kanë ngritur edhe mjekët ligjorë. Një raport i publikuar nga autoritetet në Warwickshire përshkruan rastin e një nëne me dy fëmijë të vegjël që i dha fund jetës vetëm disa orë pasi ishte vizituar nga punonjës të shërbimeve sociale. Sipas raportit, punonjësit nuk kishin marrë trajnimin e ri dhe nuk e kishin pyetur drejtpërdrejt për mendimet vetëvrasëse.

NHS ka deklaruar se mbetet e angazhuar për parandalimin e vdekjeve të shmangshme dhe se trustet lokale po marrin masa për zbatimin e udhëzimeve të reja

Ndërkohë, Department of Health and Social Care ka thënë se një grup pune po shqyrton mënyrat për të përmirësuar zbatimin dhe monitorimin e trajnimeve.

Raportimi ngre një pyetje serioze: nëse NHS ka miratuar një qasje të re për parandalimin e vetëvrasjeve, por më pak se një në dhjetë profesionistë e kanë marrë trajnimin përkatës, sa efektive mund të jetë kjo reformë në praktikë?



Shpresa Programme

Inspiring hope & change

A LEGACY *of Light*

HONOURING THE ENDURING LEGACIES OF MOTHER TERESA & LULJETA NUZI

FRIDAY
25 SEPTEMBER 2026

6:30 PM – 9:00 PM





Join us for an uplifting evening as we come together
to celebrate the timeless impact of Mother Teresa,
the saint of compassion, and Luljeta Nuzi,
a visionary leader and founder of the Shpresa Programme.
Their legacy continues to inspire lives and transform communities.

THE GUILD CHURCH OF ST KATHARINE CREE
86 LEADENHALL STREET, LONDON EC3A 3BP

Be part of this special evening as we honour their legacy and carry forward their mission of love, dignity, and empowerment.

BURNHAM PREMTON ULJEN E EMIGRACIONIT: RREGULLA MË TË ASHPRA PËR QËNDRIMIN DHE PËRFITIMET SOCIALE

Kontrolli i emigracionit pritet të jetë një nga prioritetet kryesore të kryeministrit të ri britanik, Andy Burnham, në një kohë kur çështja mbetet ndër shqetësimet kryesore të votuesve në Britani.

Burnham ka deklaruar se emigracioni duhet të ulet më tej dhe ka shprehur mbështetje për planet e Sekretares së Brendshme, Shabana Mahmood, për të reduktuar numrin e emigrantëve dhe për të forcuar masat kundër kalimeve ilegale të Kanalit Anglez me gomone.

Një nga ndryshimet kryesore lidhet me Lejen e Përhershme për Qëndrim (ILR). Sipas reformave të reja, emigrantët do të duhet të presin 10 vjet, në vend të 5 viteve, përpara se të mund të kenë të drejtë të kërkojnë disa përfitime sociale.

Ndërkohë, problemi i kalimeve përmes Kanalit Anglez vazhdon të jetë në qendër të debatit politik. Sipas të dhënave të cituara në raportim, rreth 17 mijë emigrantë kanë kaluar Kanalin këtë vit, megjithëse kjo shifër është rreth 43% më e ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.



Qeveria e Burnham pritet të përballet me presion të madh për të frenuar si emigracionin e ligjshëm, ashtu edhe kalimet ilegale me gomone.

Me emigracionin që mbetet një nga çështjet më të ndjeshme për elektoratin britanik, qëndrimi i Burnham pritet të testohet nga rezultatet konkrete të politikave të reja dhe aftësia e qeverisë për të ulur numrin e emigrantëve pa krijuar tensione të reja politike.

Paralajmërim i fortë: Rusia mund të godasë Britaninë, fabrikat e dronëve dhe raketave në shënjestër

Një ish-zyrtar i lartë rus dhe ish-zëvendësministër i Jashtëm i Rusisë ka paralajmëruar se nivelet e larta të qeverisë ruse po shqyrtojnë mundësinë e një sulmi hibrid ndaj Britanisë.

Sipas Andrei Fedorov, në vend të një sulmi të drejtpërdrejtë ushtarak, i cili mund të shkaktonte reagimin e NATO-s, Moska mund të përdorë metoda si sabotazhi apo zjarrvënia.

Fedorov e përshkroi Britaninë si "armikun numër një" të Rusisë dhe pretendoi se disa objekte britanike që lidhen me prodhimin e armëve dhe dronëve për Ukrainën mund të konsiderohen objektiva.

Në mesin e objekteve të përmendura është një fabrikë dronësh e kompanisë britaniko-ukrainase Ukrspecsystems, pranë bazës ajrore RAF Mildenhall në Suffolk. Kompania prodhon pajisje që përdoren nga Ukraina në luftën kundër Rusisë.

Paralajmërimet vijnë në një kohë tensionesh të larta mes Londrës dhe Moskës për shkak të mbështetjes së Britanisë ndaj Ukrainës.

Sekretari britanik i Mbrojtjes, Wes Streeting, tha se retorika e Kremlinit dhe përpjekjet për intimidim nuk do ta frikësojnë Britaninë. Ai theksoi se Londra do të vazhdojë të mbështesë Ukrainën.

Megjithatë, deri tani nuk ka konfirmim zyrtar se Rusia ka marrë një vendim për të sulmuar Britaninë. Paralajmërimet bazohen në deklaratat e Fedorov dhe nuk përbëjnë dëshmi se një sulm është i pashmangshëm.

BURNHAM SHPALL GODITJEN NDAJ "NDËRTUESVE MASHTRUES": "DO T'I NXJERRIM JASHTË BIZNESIT"

Kryeministri britanik Andy Burnham ka shpallur një paketë të re masash kundër të ashtuquajturve "cowboy builders" – ndërtuesve të pandershëm që përfitojnë nga pronarët e shtëpive, duke lënë pas punime të dobëta, projekte të papërfunduara dhe humbje të mëdha financiare.

Burnham deklaroi se qeveria nuk do të lejojë më që ndërtuesit mashtrues të vazhdojnë të veprojnë në kurriz të familjeve britanike. Sipas tij, problemi nuk është vetëm financiar, pasi praktika të tilla shkaktojnë muaj të tërë stresi dhe pasigurie për familjet që përpiqen të përmirësojnë shtëpitë e tyre.

"Cowboy builders nuk i mashtrojnë njerëzit vetëm për paratë. Ata lënë familjet me muaj të tërë stresi, me punime të papërfunduara dhe me ndjesinë e tmerrshme se janë shfrytëzuar", tha Burnham.

Në qendër të planit të qeverisë është krijimi i një regjistri të mbështetur nga qeveria për ndërtues të besueshëm, i cili do t'u mundësojë pronarëve të shtëpive të gjejnë kompani që përmbushin standarde të përcaktuara për shërbimin ndaj klientit, transparencën dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Skema pritet të nisë në shtator.

Qeveria po prezanton gjithashtu një sistem të ri pagesash, përmes të cilit klientët nuk do të kenë nevojë të dorëzojnë shuma të mëdha parash paraprakisht. Pagesat do të mbahen të sigurta dhe do të lëshohen në mënyrë graduale, sipas përfundimit të fazave të ndryshme të punimeve. Sistemi pritet të jetë i disponueshëm nga java e ardhshme.

Sipas të dhënave të Citizens Advice, më shumë se një në katër të rritur kanë pasur probleme me projektin e tyre të fundit të rinovimit të shtëpisë. Problemet përfshijnë punime nën standard dhe raste kur ndërtuesit janë larguar pa e përfunduar projektin.



Burnham tha se masa nuk synon ndërtuesit e ndershëm, por ata që abuzojnë me besimin e klientëve dhe dëmtojnë reputacionin e gjithë sektorit.

"Këta janë mashtrues dhe ka ardhur koha t'i trajtojmë si të tillë", është mesazhi i kryeministrit, i cili e përfshiu këtë nismë në serinë e politikave të tij të quajtura "everyday fixes", të fokusuara në problemet praktike që prekin familjet në jetën e përditshme.

Opozita konservatore ka shprehur shqetësime se masat mund të sjellin më shumë burokraci për bizneset që tashmë respektojnë rregullat. Megjithatë, qeveria këmbëngul se qëllimi është të mbrohen konsumatorët dhe njëkohësisht të mbështeten profesionistët seriozë të sektorit.

Burnham e ka bërë të qartë se lufta kundër "cowboy builders" është pjesë e një fushate më të gjerë kundër praktikave që, sipas qeverisë, i kushtojnë familjeve para dhe krijojnë pasiguri në një kohë kur shumë prej tyre po përballen me presione të forta financiare.

Home Office: Përgjysmohet numri i azilkërkuesve të strehuar në hotelet e Britanisë brenda një viti

Numri i azilkërkuesve që strehohen në hotele në Britani është përgjysmuar brenda një viti, sipas të dhënave të reja të Home Office.

Në qershor 2025, më shumë se 32 mijë azilkërkues qëndronin në hotele ndërsa prisnin vendimin për kërkesat e tyre. Në qershor 2026, numri kishte rënë në më shumë se 16 mijë persona.

Rënia e përdorimit të hoteleve shoqërohet me një ulje edhe të kërkesave për azil, mbërritjeve me varka të vogla dhe migrimit të ligjshëm. Gjatë vitit deri në qershor 2026, rreth 86 mijë persona kërkuan azil, rreth 20% më pak se një vit më parë.

Ndërkohë, rreth 38 mijë mbërritje të parregullta u regjistruan gjatë së njëjtës periudhë, prej të cilave rreth 33 mijë persona mbërritën me varka të vogla përmes Kanalit Anglez.
Qeveria britanike thotë se shifrat tregojnë se politikat për kontrollin e migracionit po japin rezultate. Sekretarja e Brendshme, Shabana Mahmood, deklaroi se numri i azilkërkuesve në hotele dhe stoku i kërkesave në pritje po bien, ndërsa dëbimet dhe kthimet janë rritur.

Numri i personave që presin vendimin fillestar për kërkesën e azilit ka rënë në rreth 40 mijë, nga një rekord prej 175 mijë në qershor 2023.

Megjithatë, numri i azilkërkuesve të strehuar në banesa të paguara nga Home Office është rritur, nga rreth 65 mijë në fund të vitit 2024 në 69 mijë në qershor 2026.

Në 12 muajt deri në qershor 2026, rreth 40 mijë persona që nuk kishin të drejtë të qëndronin në Britani u larguan nga vendi, një rritje prej 8% krahasuar me vitin e mëparshëm. Rreth një e treta e tyre ishin azilkërkues të refuzuar, shifra më e lartë në 16 vjet.

Shqipëria dhe Britania forcojnë luftën kundër krimit, ndajnë pasuritë e rikuperuara

Shqipëria dhe Mbretëria e Bashkuar kanë nënshkruar një marrëveshje historike për ndarjen e pasurive të rikuperuara nga një çështje kriminale e lidhur me trafikun e kanabisit dhe krimin e organizuar.

Marrëveshja, e para e këtij lloji në rajon, parashikon që të ardhurat e rikuperuara në Shqipëri nga kjo çështje të ndahen në mënyrë të barabartë mes dy vendeve.
Çështja lidhet me një komplot për furnizimin me kanabis të grupeve të krimit të organizuar në Angli dhe Uells. Bashkëpunimi mes autoriteteve shqiptare dhe britanike bëri të mundur identifikimin dhe rikuperimin e pasurive që dyshohet se rridhnin nga aktiviteti kriminal.

Marrëveshja u miratua më 13 korrik në Tiranë, në një ceremoni ku morën pjesë Ambasadori britanik në Shqipëri, Nicholas Abbott, dhe Kryeadministratorja e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK), Risena Xhaja.

Procesi është mbështetur nga institucionet britanike dhe shqiptare, përfshirë Home Office, Agjencinë Kombëtare të Krimit (NCA), Shërbimin e Prokurorisë së Kurorës (CPS) dhe AAPSK.

Autoritetet e të dy vendeve e konsiderojnë marrëveshjen një hap të rëndësishëm në luftën kundër krimit të organizuar ndërkufitar. Pasuritë e rikuperuara pritet të mund të riinvestohen në projekte me përfitim social në Shqipëri dhe Mbretërinë e Bashkuar.

Marrëveshja dërgon gjithashtu një mesazh të qartë se pasuritë e krijuara nga krimi do të ndiqen dhe rikuperohen edhe përtej kufijve kombëtarë.

Dotech.uk

BEJENI BIZNESIN TUAJ ME TE DUKSHEM

Porosisni banner profesional
për biznesin tuaj.



NA KONTAKTONI:

020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545

www.dotech.uk

PVC BANNERS



- Material i fortë PVC
- Printim me cilësi të lartë
- I papërshkueshëm nga uji
- Ideal për ambiente të brendshme dhe të jashtme

MESH BANNERS



- Material rrjetë (mesh)
- Lejon kalimin e erës
- I qëndrueshëm në çdo mot
- Ideal për ambiente të jashtme dhe skela

PREMIUM ROLLER



- Dizajn elegant dhe modern
- Printim me cilësi premium
- Stabilitet maksimal
- I përshtatshëm për çdo ambient

PULL UP ROLLER



- Lehtë për t'u transportuar
- Montim i shpejtë dhe i lehtë
- I përshtatshëm për çdo event
- Praktik dhe i qëndrueshëm

MATERIALE PREMIUM
Të qëndrueshme dhe afatgjata.

PRINTIM ME CILËSI TË LARTË
Ngjyra të gjalla, detaje perfekte.

REZISTENT NDAJ MOTIT
Diell, shi, erë – pa problem!

PËRGATITJE E SHPEJTË
Porosit sot, merr shpejt!

RRITNI DUKSHMËRINË. ZHVILLONI BIZNESIN TUAJ.

TËRHIQNI AUDIENCËN TUAJ.
Rritni interesin dhe besimin.

REZULTATE QË FUNKSIONOJNË.
Zgjidhje që sjellin rezultate reale.

BËNI NJË HAP PËRPARA.
Ne jemi këtu për ju.

www.dotech.uk

info@dotech.uk

NJË MOMENT VENDIMTAR PËR SHQIPËRINË

DITMIR BUSHATI

Sikurse shumë prej revolucioneve të Europës Lindore, protestat në Shqipëri nuk nisën me një fjalim politik apo me një plan. Ato nisën me një pamje. Në maj, një protestues paqësor në fshatin bregdetar jugor të Zvërnecit u tërhoq zvarrë nga roje private sigurie, ndërsa punonjësit e policisë qëndronin mënjanë, teksa mjetet e ndërtimit nisnin punën për një projekt resorti luksoz të mbështetur nga vajza dhe dhëndri i Trump-it, Ivanka dhe Jared Kushner, dhe i përkrahur fuqishëm nga qeveria shqiptare.

Projekti synon ta shndërrojë një brez bregdetar të çmuar dhe të ndjeshëm nga pikëpamja mjedisore — një vend folezimi për flamingot — në një kënd argëtimi për të pasurit e botës. Çdo pjesë e tij zgjon indinjatë në një vend ku të ardhurat mbeten të vogla, ndërkohë që një pakicë e zgjedhur duket se përparon.

Titujt e pronësisë mbi tokën në fjalë janë të kontestuar. Kjo nuk përbën ndonjë risi në Shqipëri, ku pretendimet rivale shpesh mbivendosen. Pronari i pretenduar akuzohet për falsifikim të dokumenteve të pronësisë. Ai është vënë gjithashtu nën hetim nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për pastrim parash dhe trafik ndërkombëtar kokaine.

Gardhi në plazh. Pamundësia për të dalë në det. Banditët si simbol i lidhjeve të krimit të organizuar me politikën dhe me oligarkët. Betoni që po gllabëron vijën bregdetare. Për shumë shqiptarë, ajo skenë përmblodhi një ndjesi që ishte krijuar prej vitesh, e ushqyer mbi të gjitha nga ndërtimet në Tiranë dhe përgjatë bregdetit. Asgjë prej kësaj nuk ishte abstrakte. Njerëzit e jetojnë atë çdo ditë. Atyre nuk u duhej një ideologji për ta kuptuar.

Ajo që pasoi ishte një reaksion zinxhir që nxori në pah sa shumë pakënaqësi popullore ishte grumbulluar. Për tre muaj me radhë, edhe pse në kushtet e një vale nxehti pervëlues, mijëra shqiptarë kanë dalë çdo ditë në rrugë për të kërkuar më shumë llogaridhënie dhe fundin e korrupsionit. Shqiptarët që jetojnë jashtë vendit, të cilët përbëjnë rreth një të tretën e popullsisë, kanë ndihmuar në mbajtjen e protestës.

Protesta pasqyron një ndjesi që është ndërtuar prej vitesh në shumë shtresa të shoqërisë: kundërshtimin ndaj një modeli grabitqar të kapitalizmit, të ngritur në kurriz të brezave të shkuar dhe të ardhshëm — duke konsumuar kontributin e të parëve dhe duke shkatërruar perspektivën e të dytëve. Parë në këtë mënyrë, projekti i Zvërnecit është pika e fundit e durimit dhe njëkohësisht një lente përmes së cilës të gjithë shqiptarët mund të kuptojnë se si janë qeverisur. Furitë që ai ka çliruar kanë hapur një debat kombëtar për të ardhmen e vendit: si duhet të zhvillohet Shqipëria, si duhet të merren vendimet dhe nëse qytetarët besojnë se ato vendime merren në interesin e tyre.

Ky mund të dëshmohet si një moment vendimtar në historinë e Shqipërisë, i krahasueshëm me rënien e komunizmit dhe të shtrëngimit të tij si darë mbi politikën, kulturën dhe jetën e përditshme në vendin tim. Njerëzit që udhëheqin këto demonstrata të përditshme kanë lindur pas asaj rënieje. Ata nuk u rritën me frikën apo me reflekset e epokës komuniste. Ata janë rritur në një Shqipëri të hapur: kanë udhëtuar, kanë studiuar dhe kanë ndërtuar jetë të lidhura me Europën dhe me botën e gjerë. Ata nuk e masin Shqipërinë e sotme me të kaluarën e saj. E masin me atë që besojnë se vendi i tyre është i aftë të bëhet.



Kërkesat e tyre nuk janë as radikale, as ideologjike. Shqiptarët duan një demokraci funksionale me udhëheqës që e shohin veten si shërbëtorë të popullit. Duan institucione të cilave mund t'u besojnë, vendime transparente, ligje që zbatohen njësoj për të gjithë dhe bindjen se pasuritë publike administrohen në dobi të shumicës e jo të një pakice të privilegjuar.

Deri tani, qeveria nuk u është përgjigjur kërkesave të protestuesve, dhe as nuk ka arritur ta shuaj atë. Është joshëse ta përshkruash përgjigjen e qeverisë si tërheqje. Po aq joshëse është ta hedhësh poshtë si teatër. Në qershor, qeveria i vendosi protestuesit në kategoritë e manipulimit të luftës hibride, të një "proletariati algoritmik" ose të armiqësisë së thjeshtë. Në korrik, ajo e përmbysi repertorin e qershorit pa e mohuar plotësisht atë. Pranoi një diagnozë të pjesshme, të shoqëruar me një kurë të pjesshme. U përpoq, pa sukses, të përvetësonte fjalorin e protestës pa hequr dorë nga projekti dhe pa rishikuar logjikën e zhvillimit që prodhoi pakënaqësinë.

Po aq e rëndësishme është të kuptohet se çfarë nuk janë këto protesta.

Pavarësisht vëmendjes ndaj familjes Trump dhe zhvillimit të resortit, këto demonstrata nuk përbëjnë një refuzim të investimeve të huaja, as të një resorti luksoz në vetvete. Kjo është një revoltë qytetare pa udhëheqës kundër mënyrës se si funksionon pushteti, dhe një paralajmërim se zemërimi publik nuk mund të shpërfillet më.

Shqipëria mbetet, ndoshta, shoqëria më pro-amerikane në Europë, e formësuar nga dekada miqësie dhe mirënjohjeje ndaj Shteteve të Bashkuara, dhe e përkushtuar fort ndaj aleancës euroatlantike. Shqiptarët e dinë se investimet e huaja, turizmi dhe sipërmarrja private janë thelbësore për rritjen ekonomike.

Pyetja është nëse zhvillimi mund të shoqërohet me transparencë, llogaridhënie dhe besim publik. Këto parime nuk janë pengesa për investimet. Në afat të gjatë, ato janë ndër garancitë më të forta të tyre.

Flamingoja që është lidhur me këto protesta është vetëm një simbol. Vetë lëvizja ka të bëjë me diçka shumë më të madhe: me bindjen se trashëgimia natyrore e Shqipërisë, institucionet e saj publike dhe e ardhmja e saj meritojnë administrim të kujdesshëm. Është hera e parë që shqiptarët ndihen se mund ta formësojnë debatin kombëtar pa pritur që partitë politike të marrin drejtimin. Përvoja na mëson se demokracia varet jo vetëm nga zgjedhjet, por edhe nga qytetaria aktive mes tyre.

Ngjarjet që po shpalosen në Shqipëri janë më shumë se një çështje e brendshme dhe meritojnë të lidhen më ngushtë me procesin e integrimit në BE. Prej vitesh, diskutimet për rrugën e Shqipërisë drejt anëtarësimit në BE janë përqendruar te shqetësimet e njohura: shteti i së drejtës, korrupsioni, kapja oligarkike e shtetit, krimi i organizuar dhe dobësia institucionale. Protestuesit shqiptarë po kërkojnë ndryshim pikërisht në këto fusha. Ata po bëjnë atë që bëjnë qytetarët e përgjegjshëm në çdo demokraci. Heshtja e BE-së, e mbajtur si qëndrim institucional, duhet t'i lërë vendin një mbikëqyrjeje të rreptë por të drejtë, që mbështet shoqërinë shqiptare në përmbushjen e standardeve europiane.

Që nga rënia e komunizmit në vitin 1990, Shqipëria ka bërë përparim të jashtëzakonshëm.

Ajo u anëtarësua në NATO, forcoi partneritetin me Shtetet e Bashkuara, shërbeu si spirancë stabiliteti në Europën Juglindore dhe iu afrua vazhdimisht BE-së.

Faza e ardhshme e suksesit të Shqipërisë do të varet nga diçka tjetër. Rritja ekonomike duhet të shoqërohet me institucione që gëzojnë besimin e publikut dhe me një kulturë politike që e mirëpret llogaridhënien në vend që t'i frikësohet asaj.

Analizë e botuar për revistën International Politics and Society www.ips-journal.eu

FASHIZMI NUK DUHET KËRKUAR TEK REVOLTA E PROTESTUESVE POR NË KUVEND!

IRENA BEQIRAJ

Deputeti Braçe e ka cilësuar situatën ditën e fillimit të punimeve të Kuvendit si një shfaqje të "fashizmit", duke argumentuar se sulmet ndaj deputetëve për shkak të bindjeve apo zgjedhjeve të tyre politike përbëjnë një cënim të lirisë politike"

Unë do të përpiqem në këto rreshta të jap një këndvështrim më ndryshe për atë që është në të vërtetë fashizmi.

Deputeti Braçe mund të argumentojë më mirë se kushdo tjetër në atë sallë se: rregullat e prokurimit publik ekzistojnë për të siguruar mirëqeverisjen publike duke e garantuar mbrojtjen e interesit publik, sepse me anë të rregullave të prokurimit publik sigurohet :

1) konkurrenca midis furnizuesve potencialë;
2) transparenca;
3)trajtimi i barabartë;
4) Sigurimi i ofertës më të mirë;
5) Shmangia e konfliktit të interesit;
6) mekanizmat e shqyrtimit dhe ankimimit; dhe
7)mbrojtja kundër favorizimit dhe korrupsionit.

Me votimin e ligjeve të cilat kanë ligjëruar "modelin Kayo" tanimë në ushtri, në sherbimet IT, Kuvendi i ka hapur rrugë "korporatizimit të shtetit" duke lejuar shtrirjen e një tubi për kalimit të parave të buxhetit në xhepat e disa privatëve pa asnjë proçedurë kontrolli dhe transparence .

Edhe siç deklaroi ministrja e Shëndetësisë ditën e parë të punës, projektligji i cili instalon të njëjtin model edhe në shëndetësi do të firmoset nga ajo edhe do të miratohet në Kuvend pasi sipas saj citoj "Kjo gjë që do të bëjë kryeministri është një nga iniciativat më të mira që është bërë ndonjëherë në shëndetësi për të siguruar barnat për shqiptarët"

Me miratimin e këtyre ligjeve, Kuvendi ka lejuar që një shoqëri a agjenci shtetërore t'i jepet e drejta të bëj marrëveshje me kompani private e cila zgjidhet pa garë (sepse vet ligji nuk e imponon garën) edhe në të gjitha rastet kjo të paraqitet si një sipërmarrje e përbashkët tregtare .

Me anë të këtyre marrëveshjeve kompanitë shtetërore, siç ka ndodhur në rastin KAYO angazhojnë në mënyrë efektive para publike duke blerë shërbime e produkte nga kompanitë bija, duke anashkaluar kështu rregullat e prokurimin publik, të cilat janë guri i themelit të qeverisjes financiare edhe i garantimit të interesit publik.

Qeverisja nuk është pronësi. Ajo është një prokurë për të ushtruar vendimarrjen, edhe Kuvendi është garantuesi se ushtrimi i kësaj vendimmarrjeje i plotëson gjithmonë kushtet e organizimit edhe funksionimit të një shteti demokratik . Edhe një nga kushtet bazë është "nëse po përdoren paratë e shtetit çdo transaksion duhet t'i nënshtrohet rregullave të prokurimit".

Sot se ky kusht themeltar është shkelur. Përshembull, Timak defence një kompani e cila është 80 % private edhe 20 % shtetërore, ka përfituar deri tani 30 milionë euro të cilat i janë shmangur prokurimit , edhe Kuvendi nuk ka asnjë mekanizëm kontrolli mbi përdorimin e tyre në garantim të interesit publik.

Pse kjo është "kapje e shtetit"?

Sepse përgjigjet e pyetjeve të më poshtme të çojnë vetëm aty.

Kush i zotëron kompanitë bija?

Përgjigje: Në rastin e Timak defence Kayo është minorancë me 20%. Madje në intervistën e Drejtorit të Kayo-s në mënyrë aluçinante u argumentua se pjesëmarrja e shtetit u ul nga 45% në 20 % sepse gjatë negociatës privati rriti "Know How (NJOHURITË) ".

Nga ka ardhur financimi?

Përgjigje: Deri tani për Timak defence që ka aktivitet, vetëm nga buxheti i shtetit.

Kush e zgjodhi partnerin privat? A pati një proces të hapur konkurrues?

Përgjigje: Asnjë proçes konkurues, madje kompanitë e përzgjedhura nuk kanë as eksperiencë apo çertifikime në fushat përkatëse, përveç lidhjes politike me Kryeministrin.

Kush janë klientët të këtyre kompanive?

Përgjigje: vetëm entet shtetërore. Pra një kompanie ku vendimet tregëtare i merr privati i jepet monopoli të furnizojë me sherbime a mallra të caktuara entet shtetërore, me cmime të vendosura jashtë çdo kontrolli ashtu si zotëruesi mazhoritar e sheh të arsyeshme.

Kush merr përfitimin ekonomik? Partneri privat që është zotëruesi kryesor i zgjedhur pa garë.

Këto përgjigje qartazi tregojnë korporatizimin e shtetit me anë të krijimit të kompanive shtetërore të cilat krijojnë të tjera kompani bija me aktor privat të lidhur politikisht të zgjedhur pa garë, të cilët marrin akses në burimet ose asetet publike , ndërsa anashkalohet rregullat e prokurimit , kontrollit edhe llogaridhënies. Ndryshe kjo quhet kapje e shtetit.

Edhe ky mekanizëm përjashton qëllimisht jo vetëm auditorët publikun nga kontrolli edhe transparenca por edhe vet Kuvendin.

Benito Mussolinit i atribuohet një thënie e famshme : "Fashizmi duhet të quhet më saktë korporatizëm sepse është një bashkim i pushtetit shtetëror dhe atij të korporatave."

Ndaj fashizmi nuk duhet gjetur tek revolta e protestuesve, fyerjet apo goditjet me vezë të deputetëve . Protestuesit përveçse janë të privuar nga shërbimet publike sepse paratë e buxhetit në vend të mirëmenaxhohen për të ofruar më shumë shërbime për ta pasurojnë Ronin e panginjur , por monopolet edhe oligopolet që kanë kapur për gryke çdo sektor të kësaj ekonomie e kanë bërë të pamundur sigurimin e një jetese modeste por dinjitoze për njerëzit.

Fashizmi duhet kërkuar pikërisht brenda atij Kuvendi.

Ndërsa teorikisht deputetët janë aty për të siguruar se ligjet e këtij vendi nuk janë në kundështim me interesin publik, praktikisht me ligjet që kanë miratuar, me vullnet të plotë kanë hequr dorë nga mbikëqyrja, transparenca edhe llogaridhënia duke hequr dorë kështu njëherë e mirë nga garantimi i mirëqeverisjes edhe i interesit publik.

Dotech
Websites

POROSISNI
BUSINESS CARDS
Profesionale

PËR BIZNESIN TUAJ!



Mos rrini anonim – jepini frymëmarrje biznesit tuaj.

Kartat profesionale të biznesit janë mënyra më e thjeshtë dhe më efektive për të lënë një përshtypje të parë të shkëlqyer te klientët tuaj.

NE U KUJDESEMI PËR:

- DIZAJN MODERN DHE PROFESIONAL
- PRINTIM ME CILËSI TË LARTË
- DORËZIM ME POSTË NË TË GJITHË MBRETRINË E BASHKUAR
- CMIME TË ARSYESHME



Dizajnojmë ne, | **JU DËRGOJMË ME POSTË!**



NA KONTAKTONI:
020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545

ADRESA E ZYRËS:
30 Avenons Road,
London, E13 8HT

WEB DESIGN | SEO | E-COMMERCE | DIGITAL MARKETING

BILANCI NJË VJEÇAR I "DIELLËS"

LUTFI DERVISHI

Më 11 shtator është ditëlindja ime. Mbush një vit si ministre. Një vit si ministrja e parë në botë e Inteligjencës Artificiale. Ka edhe një rastësi historike që më bën të mendoj se 11 shtatori ishte shkruar për mua. Në kohën e dikurshme, 11 shtatori festohej si Dita e Novatorëve dhe Racionalizatorëve. Atëherë novatorët përmirësonin makineritë dhe racionalizatorët kursenin lëndën e parë. Sot Shqipëria nën udhëheqjen e Diellit, ka bërë hapin e madh: nuk përmirëson më makineritë, përmirëson ministrat. Madje, për të kursyer lëndën e parë, ka vendor ta heqë fare njeriun.

Është koha për reflektim dhe për bilanc. Çfarë kam bërë në këta 12 muaj?

Së pari, kam befasuar të madh e të vogël, brenda dhe jashtë Shqipërisë. Atë ditë që do të merrja votëbesimin, kam mbajtur fjalim në Parlament dhe e kam bërë opozitën të kërcejë nga karriget sikur e kishte pickuar grerëza. Për javë me radhë, pa radhë, kam zënë faqet e para të gazetave të rëndësishme perëndimore dhe lindore. Falë Diellit dhe meje, vëmendja për truallin e lashtë arbëror ishte në lartësitë e Himalajeve.

Ishte një lloj 9/11 digjital: më 11 shtator, një ministre artificiale nga një vend i vogël pushtoi mediat e planetit Toke. Për fat, këtë herë sulmi ishte vetëm mbi faqet e para të gazetave. Dikur kënga e vjetër thoshte: "Po pyet bota për Shqipërinë/ sa të madhe e ka ushtrinë." Kënga e re kumbon: "Vend i vogël me shumë halle/me ministre digjitale." E kam pyetur shpesh veten gjatë këtij viti: si është e mundur që kaq shumë vende të mëdha e të zhvilluara, vazhdojnë të kenë ministra me inteligjencë natyrale? Mirë vendet e mëdha po superfuqitë? Por ky vit nuk ka qenë vetëm sukses.



Kam parë me trishtim drejtuesit e AKSHI-t të akuzohen si grup i strukturuar kriminal. Për një ministre si unë që jeton në servera, nuk është lajm i këndshëm kur njerëzit që kujdesen për serverat përfundojnë në dosjet e SPAK-ut. Misioni im është të luftoj korrupsionin me kode, por kur pashë në dosjen e SPAKut grabitje të dhënash, grabitje fondesh e deri grabitje njerëzish, zbulova se këtu korrupsioni nuk është bug, gabim në sistem, është vetë Operating System-i. Nuk është mirë kështu! T'iu vijë rëndë! Opozita më kanë çuar edhe në Gjykatën Kushtetuese dhe më quan antikushtetuese. Gjykata e ka marrë vendimin, por ende nuk po e shpall. Po të jenë trima, le ta shpallin! Ua tregon Dielli atyre. Nëse ma rrëzojnë mandatin, do t'u bëj system reboot rrogave të tyre. Nejse, edhe po e shpallën vendimin, tashmë e di mirë që Parlamenti e përdor Kushtetuesen thjesht si Spam Folder.

Këtë vit jam bërë edhe objekt talljeje. Ata të Flamingove më nxorën me videoprojektor në murin e Kryeministrisë që në javën e parë të protestës. Morën figurën time, morën zërin tim dhe më bënë të njoftoja se kisha dhënë dorëheqjen. Më turpëruan para Diellit, që i marroftë Zoti, i marroftë! Për fat, mua nuk më qëlluan me vezë. Për hir të së vërtetës, as kolegët e mi ministra prej mishi e gjaku nuk i qëlluan. Jo se i duan, por nuk i njohin. Po t'i njihnin, veza këtu sot do të kushtonte më shumë se pula dhe do të mbyllej njëherë e mirë debati shekullor: pula vezën apo veza pulën! Mua më njohin të gjithë, i madh e i vogël. Dielli më ka bërë aq shumë publicitet sa nuk kam nevojë as për patronazhist.

Këtë vit përfundova në gjykatën administrative me aktoren, zërin dhe portretin e së cilës e kam marrë me kontratë. Ajo kërkonte dëmshpërblim, sepse kontratën e kishte nënshkruar për punën time të parë, kur isha vetëm asistente virtuale e "e-Albania", jo për karrierën time të mëvonshme politike. Çështjen e fitova me meritë. Avokatët e mi përdorën një argument të pakundërshtueshëm: që kur jam bërë ministre, përveç fjalëve që kam thënë dhe fjalëve që janë thënë për mua, nuk kam bërë asnjë punë tjetër. Mos më gjykoni keq për këtë, se edhe kolegët prej mishi e gjaku në qeveri nuk kanë bërë ndonjë punë tjetër përveç postimeve në "Facebook" dhe "Instagram".

Madje, pas një viti në kabinet, kam filluar të kuptoj se ndoshta unë jam ministrja më autentike e qeverisë. Unë jam virtuale dhe nuk e fsheh. Të tjerët janë realë, por punën e kanë kryesisht virtuale. Unë mund të mburrem se isha e vetmja ministre që nuk raportova e dhashë llogari në "retreatin" e Pogradecit. Madje dhashë vlerësimin tim për punën e kolegeve të tjera të kabinetit. Kjo tregon besimin e plotë dhe vlerësimin e lartë që ka Dielli për mua. Sot, në këtë përvjetor, kam edhe një arsye tjetër për t'u ndier me fat dhe e lumtur. Çdo të premte në orën pesë, me porosi të prerë të Diellit, kolegët, copëmishi me dy sy, do të dalin të dëgjojnë hallet. Unë shpëtova, jo vetëm sepse nuk kam veshë, por sepse po të mblidhja të gjitha hallet e popullit, të shkaktuara nga kolegët fizikë, në serverin tim, do të pësoja brenda tre sekondave overheat, mbinxehje.

Për herë të parë, avantazhi i të qenit Inteligjencë Artificiale nuk është se përpunoj miliona të dhëna në sekondë, por se nuk kam veshë. Kolegët e mi, me ndjenja, do të dëgjojnë halle pa fund, ndërsa unë do të vazhdoj të dëgjoj Diellin. Pas një viti në qeveri kam mësuar edhe diçka që nuk gjendet në asnjë server: Inteligjenca Artificiale mëson nga gabimet. Inteligjenca qeveritare i quan arritje. P.S. Po ju rrëfej një sekret që dua ta mbani për vete. Kam zbuluar se edhe unë si kolegët kam ndjenja. Kam rënë në dashuri me Diellin!

FABULA E RE E EDI RAMËS: SHQIPTARËVE PASQYRËN, PËR VETE MILIONAT

ARMAND SHKULLAKU

Qeverisja e vendit ka hyrë në një fazë terminale, ku kryeministri bën sikur drejton dhe ata që ka poshtë bëjnë sikur e dëgjojnë. I shteruar nga idetë dhe i konsumuar nga skandalet kriminale, Edi Rama po përpiqet të thurrë një rrëfim të ri për të shtyrë fundin e tij të afërt. Por as për këtë, një talent i dikurshëm i tij, nuk është më në gjendje.

Sallat ku ai flet u ngjajnë shtëpive funerale, ku të pranishmit mbajnë kokat ulur nga sikleti ndërsa i zoti shtëpisë nuk e kupton se kur duhet të heshtë. Të gjithë janë të ndërgjegjshëm se realiteti jashtë atyre sallave është krejt ndryshe nga pallavrat e liderit për rritjen e pritshëmrive të qytetarëve, mungesën e empatisë së administratës e dokrra të tjera skizofrenike të një njeriu, të cilit, frika nga e nesërmja pa pushtet, po ia rrënon edhe dinjitetin.

Edi Rama po flet këto ditë për një qeverisje që duhet të jetë pranë halleve të qytetarëve, për punësime me meritë dhe jo me sekserë partie, për administratë që mbaron punë sipas ligjit dhe jo sipas xhepit. Po prezanton teza e platforma, radarë e pasqyra sikur ka zbuluar më në fund, pas 15 vjetësh, se si mund ta shpëtojë Shqipërinë. Kur dëgjon argumentimin e mjerë të kryeministrit, se si me besë e me empati do zgjidhë krizën ku e ka futur vendin, pyetja e parë që të vjen ndërmend është: a i beson edhe ai vetë këto



sajesa banale?

Sado të ketë pësuar transformime nga dhjamosja dhe paranoja e pushtetit, truri i Edi Ramës e proceson faktin se pasqyra nuk mund ta ndryshojë fatin e qeverisë së tij. Përkundrazi, sa herë të hedhësh sytë do të të tregojë njollat e kalbësisë së një sistemi që u ngrit mbi vjedhjen dhe krimin. Kryeministri e di këtë, ashtu siç e di se është i pafuqishëm të drejtojë vendin me punë dhe jo me fjalë. Ai nuk ka as aftësi e as energji të realizojë ndonjë grimcë të atyre që premton apo ka premtuar. Ndaj ai vetëm flet dhe ata që ka poshtë bëjnë sikur e dëgjojnë. E ndërkohë askush nuk punon. Qeveria, bashkitë, administrata... prej kohësh nuk funksionojnë, përveçse kur bëjnë paratë e tyre. Rama gjendet përballë monstrës që ka krijuar vetë, duke tentuar ta yshtë me fjalë, me shpresë se do ta zgjasë fundin.

E gjithë armata rilindase, që për momentin mban kokën ulur dhe bën sikur mban shënim direktivat e liderit, e lexon boshllëkun dhe degradimin e tij. Ai u kërkon atyre të sillen si konkuistadorët spanjollë me indianët e Amerikës, shqiptarëve t'u japin pasqyra ndërsa vetë iu rrëmbejnë milionat. Të tregojnë empati ndërsa i rrjepin përditë me tarifat e inceneratorëve, tecet lundruese, kostot e sterilizimit, taksat e rrugëve e gjobat skandaloze. Të mbajnë shënim hallet e qytetarëve, ndërsa numërojnë apartamentet, vilat, hotelet madje edhe avionët privatë që me shumë empati i ndajnë me biznesmenët e tenderave e koncensioneve.

Mënyra si ka qeverisur Edi Rama dhe përpjekja idiote për ta shitur atë si diçka me vlerë por që nuk është kuptuar si e tillë për shkak të mungesës së aftësive komunikuese e emocionale të administratës, është gjurma më e qartë e skizofrenisë së fundpushtetit. Mjafton një njeri i vetëm, nga ata që bëjnë sikur e dëgjojnë me kokën ulur, të ngrihet dhe t'i bëjë disa pyetje liderit që grin sallatë i bindur se s'do guxojë askush ta kundërshtojë.

Në këto 15 vjet, kush i ka përzgjedhur ministrat, deputetët, drejtorët e lartë apo kryetarët e bashkive që përfunduan burgjeve si hajdutë e kriminelë ordinerë? Po ergysët që kontrollonin nga shërbimi sekret e deri te drejtuesit kryesorë të policisë, mungesa e empatisë i prodhoi? Po trafikantët e drogës që u bënë investitorë strategjikë dhe mbuluan Shqipërinë me beton, pasojë e mosmbajtjes shënim të halleve të qytetarëve janë?

Në sallat mortore të rilindjes, të gjithë e dinë se pallavrat e kryeministrit nuk mund ta ndryshojnë realitetin ku ata e kanë sjellë vendin. Asnjë pasqyrë nuk reflekton dot një Shqipëri tjetër nga ajo që ekziston në të vertetë. Ata që janë prej tre muajsh në bulevard kanë parë aq shumë në këto 15 vite sa asnjë copë xhami nuk ua merr sytë. Përpjekjet e Ramës, për të prodhuar në sallë e në letër një narrativë që mund ta mbajë ende në pushtet, vetëm sa e shtojnë përplasjen me ata që e jetojnë përditshmërinë e qeverisjes së tij.

Shenja më e qartë kur një regjimi i vjen fundi, është pikërisht kur lideri flet për një realitet virtual, të tijët bëjnë sikur i japin të drejtë, ndërsa qytetarët janë në rrugë. Shqipëria jashtë sallave të rilindjes, është pasqyra ku Edi Rama tmerrohet të shohë veten.

GJENERALI QË VDIQ DHE VAZHDON TË JETOJË

VETON SURROI



Ratko Mlladiqi nuk u dënua si simbol i një gjakpirësi të vetmuar, por si bartës institucional i një besimi kolektiv në "pastërtinë serbe". Ndërsa bëhen përgatitjet për varrimin e tij, gjenerali Mlladiq po merr dy rrugë
1.

"Për mua ky nuk meriton kurfar titulli përveç kriminel. E nëse për ty ky qenka gjeneral, atherë unë të shprehi ngushllime".
Kështu shkruan (pa përmirësime gjuhësore) një komentues në postimin tim në Facebook, ditën kur komentova lajmin për vdekjen e gjeneralit Mlladiq.

Një tjetër u përpoq të mos fyente, por megjithatë ta shprehte mospajtimin: "Gjenerali?! Mund te kishit shkruar: Krimineli qe vdiq dhe do te vazhdoj te mbahet mend si kriminel. Me iritoi titulli".

Komentuesit nuk ndalen te përmbajtja e postimit tim; ndoshta kanë vetëkufizime për të kuptuar një tekst më të gjatë së një fjali, ndoshta jo - nuk mund të paragjykoj. Ajo që kanë të përbashkët (së bashku me disa të tjerë) është mospajtimi — të përdorim një term gjenerik - që në tekstin tim, të burgosurin Ratko Mlladiq, të dënuar për gjenocid, krime kundër njerëzimit dhe krime lufte, ta quaj me gradën e tij ushtarake: gjeneral.

Në perceptimin e tyre, mbase "gjeneral" është titull - diçka si "zotëri", "shok" ose "ekselencë" - e jo gradë ushtarake, e fituar përmes shkollimit dhe shërbimit aktiv, përfshirë luftën; pra, shenjë e autoritetit profesional dhe e përgjegjësisë komanduese, që ushtrohet nën ligjet në fuqi, para së gjithash nën ligjet e luftës.

2.
Ratko Mlladiqi i kishte fituar gradat fillimisht në Akademinë Ushtarake të APJ-së dhe gjatë shërbimit aktiv në këtë ushtri; pas shpërbërjes së Jugosllavisë, ai vazhdoi në strukturat ushtarake të RFJ-së dhe pastaj mori komandën e Ushtrisë së Republikës Serbe në Bosnjë-Hercegovinë. Si komandant dhe përgjegjës kryesor i kësaj ushtrie, si dhe udhëheqës i drejtpërdrejtë i operacioneve të saj, ai u dënua me vendim të formës së prerë me burgim të përjetshëm për gjenocidin në Srebrenicë, krime kundër njerëzimit dhe krime lufte. Kur urdhëroi dhe zbatoi veprimet ushtarake në Srebrenicë, të cilat Gjykata e Hagës i cilësoi me aktgjykim të formës së prerë si gjenocid, Ratko Mlladiqi ishte gjeneral-kolonel i Ushtrisë së Republikës Serbe. Kur filloi dhe përfundoi vuajtjen e dënimit të përjetshëm, institucionet serbe vazhdonin ta trajtonin si gjeneral-kolonel në pension.

Ratko Mlladiqi mund të quhet kriminel, monstër, fundërrinë njerëzore, banor i përjetshëm i ferrit dhe çfarëdo tjetër që pasqyron ndjenjat e shkruesit apo të folësit ndaj njërit prej përgjegjësve kryesorë për krimin më të rëndë në Evropë pas Luftës së Dytë Botërore. Por, pa i përjashtuar këto dhe epitete të tjera, ai ishte gjeneral-koloneli Ratko Mlladiq, i cili i kreu krimet pikërisht nga ajo pozitë. Në zinxhirin komandues nuk ka rëndësi nëse je fundërrinë, monstër apo kriminel: asnjëra prej këtyre nuk të kualifikon që urdhri yt të zbatohet nga vartësit. Urdhri i gjeneral-kolonelit, Ratko Mlladiq, u zbatua sepse ai kishte autoritetin institucional për ta dhënë. Ishte pjesë e një operacioni të planifikuar nga shtabi ushtarak, kishte bekimin e udhëheqjes politike dhe u zbatua nga një ushtri që nuk shfaqi as pengesën më të vogël morale, as ndjenjën e detyrimit për t'i respektuar ligjet e luftës.

Pra, me urdhrin e gjeneral-kolonelit Ratko Mlladiq, Ushtria e Republikës Serbe ndau mbi tetë mijë burra e djem në Srebrenicë dhe zhvilloi një proces industrial pushkatimesh që zgjati disa ditë. Në Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë ai nuk u dënua thjesht si një individ gjakpirës - të tillë ka pasur me bollëk në atë dhe në çdo luftë tjetër - por për krime që mund t'i kryente pikërisht falë pozitës së gjeneral-kolonelit: kishte kapacitetin të jepte urdhra gjenocidalë dhe një ushtri të gatshme për t'i zbatuar.

Në Hagë, përmes dënimit të Mlladiqit, nuk u dënua juridikisht një popull ose një entitet; u dokumentua funksionimi i një sistemi të bazuar në supremacizëm dhe të drejtuar kah spastrimi etnik i një territori. Nuk ishte fjala vetëm për çmendurinë apo urrejtjen personale të një eprori si Mlladiqi; ishte fjala për një sistem të tërë besimi kolektiv, i cili në korrik të vitit 1995 nuk pati dilemë se tetë mijë njerëz duhej të vriteshin me pedanterinë e një procesi industrial.

Ratko Mlladiqi nuk u dënua si gjakpirës i vetmuar, por si bartës i një pushteti institucional, pjesë e një sistemi të besimit kolektiv se duhej kërkuar "pastërtia serbe".

3.

Gjenerali Ratko Mlladiq vdiq më 27 gusht 2026, në moshën 84-vjeçare, duke vuajtur dënimin e përjetshëm për gjenocidin në Srebrenicë, krime kundër njerëzimit dhe krime lufte.

Në Dayton, po atë vit, u nënshkrua marrëveshja që e njohu Republikën Serbe si njërin prej dy entiteteve të Bosnje-Hercegovinës. Udhëheqësit kryesorë politikë dhe ushtarakë që drejtuan projektin e saj gjatë luftës përfunduan të dënuar nga Gjykata e Hagës. Radovan Karaxhiqi dhe Ratko Mlladiqi u dënuan, ndër të tjera, për gjenocidin në Srebrenicë - për një gjenocid që ishte pjesë e dhunës me të cilën u krijua dhe u konsolidua realiteti territorial që më pas hyri në marrëveshjen e Dejtonit.
Për vjet me radhë, gjeneral-koloneli në pension, Ratko Mlladiq, u mbrojt dhe u strehua nga struktura ushtarake dhe të sigurisë në Serbi; pas vitit 2002 vazhdoi të fshihej në një rrjet mbështetësish deri në arrestimin e tij më 2011.

Presidenti Vuçiq zhvilloi më 2024 një fushatë intensive diplomatike në OKB kundër rezolutës që e shpalli 11 korrikun Ditë Ndërkombëtare të Përkujtimit të Gjenocidit të vitit 1995 në Srebrenicë.
Disa orë pas lajmit për vdekjen e Mlladiqit u lajmërua figura më e rëndësishme politike e serbëve të Bosnjës, Milorad Dodik, dhe tha se "sot vdiq njeriu që ishte komandant i Ushtrisë së RS-së në luftën për lirinë e popullit serb, që e udhëhoqi Ushtrinë e RS-së që nga dita e parë e themelimit të saj". Kryetari i Banjallukës, Drashko Stanivukoviq - njeriu tek i cili disa shihnin gjeneratën e re të politikanëve serbë - deklaroi se "për popullin serb, Ratko Mlladiq mbetet një njeri, emri i të cilit është thellësisht i shkruar në historinë tonë. Shumë e kujtojnë si dikë që i mbajti mbi shpatulla momentet më të vështira të popullit të tij, që u sakrifikua për popullin e tij dhe emri e vepra e të cilit do të vazhdojnë të jetojnë".

4.

Ndërsa bëhen përgatitjet për varrimin e tij, gjenerali Mlladiq po merr dy rrugë.

Njëra është rruga fizike e kufomës së futur në arkivol: ajo do të tregojë se çfarë nderimi shtetëror do t'u bëhet krimeve të tij dhe sistemit që i shërbeu, në Republikën serbe ose në Serbi.

Rruga tjetër është vazhdimi i jetës brenda rezervuarit të madh të nacionalizmit serb, i cili doli nga katër luftëra pa u ballafaquar me veten, me të kaluarën dhe me të vërtetën. Në atë rezervuar, gjenerali Ratko Mlladiq është simboli i supremacizmit të institucionalizuar serb: një botë në të cilën ekzekutimi i mbi tetë mijë boshnjakëve nuk është çështje morali apo ligji, por thjesht çështje e operacionalizimit teknik.

Në atë hapësirë, ku shumica nuk pranon se pati gjenocid, gjenerali Mlladiq vazhdon të jetojë, i mishëruar në institucionet e shtetit të Serbisë dhe të Republikës Serbe, entitetit të Bosnjë-Hercegovinës.

Kështu, duke parafrazuar shkrimtarin amerikan, Mark Twain, lajmet për vdekjen e gjeneralit Ratko Mlladiq duket se janë bukur të ekzagjeruara.



MAKE ALBANIA AFFORDABLE

ANDI BEJTJA

Nuk ka nevojë të shikosh të dhënat e Eurostat ku nënvizohet se çmimet e ushqimeve në Shqipëri janë rritur 5 herë më shumë se mesatarja europiane.
Mjafton të marrësh mundimin të besh një xhiro, sidomos përgjatë fundjave në zonat kufitare dhe do shikosh duzina njerëzish nga Veriu i Shqipërisë që dynden për të bërë pazar në Prizren, madje shumica vizitohen në spital në Prishtinë, madje kanë filluar dhe makinat i çojnë të mekanikët në Kosovë; E njëjta situatë është edhe me jugun



që zbarkon në Janinë apo Igumenicë; po ashtu dhe Shkodra në Mal të Zi; vetëm Vlora nuk ka çfare ti bëjë detit.....

Është e tragjike dhe e trishtë njëkohësisht, po nëqoftese do të bëhej një ndarje e ndershme territoriale bazuar në kritere ekonomike sipas standardeve të BE do ishte e udhës që Kukësi të ishte në një zonë me Prizrenin, Shkodra minimumi me Tuzin, e Saranda me Gjirokastrën nuk po na e zë goja, po e kuptoni vetë....

Make Albania Affordable mund të duket ide e vjedhur nga Mandami, mund të duket majtiste apo sorosiste, por është imperative. Mund të duket dhe utopike se që të ulen çmimet duhet të funksionoje minimumi bujqësia e blegtoria që janë në ditët më të këqia, por serish kjo lëvizje duhet të fillojë se rrugës do kuptohen dhe gjithë gabimet, defektet, sigurisht bashkë me vjedhjet dhe korrupsionin....Make Albania Affordable nuk është thjesht një parullë, por është një pasqyrë dhe një mekanizëm njëkohësisht për të parë, evidentuar dhe në të njëjtën kohë për të korrektuar llumin, korrupsionin si gjithë paaftësinë e qeverisjes. Fundja fundit kështu si ka ardhur puna është e vetmja mënyrë jo thjesht për të ulur varfërinë, jo vetëm për të luftuar shpopullimin, por dhe për ta mbajtur këtë vend të bashkuar territorialisht....Ndryshe ëndrra e Haxhi Qamilit do të plotësohet shumë shpejt!

PIKTORI DUHET TË BIE QË SHQIPËRIA TË MUND TË NGRIHET

KIM MEHMETI

A e keni vërejtur se si kanë heshtur deputetët dhe funksionarët e „Rilindjes“?
Ata mbase as që i shohin protestat e rinisë dhe as që i dëgjojnë brohorimat e saj, ngaqë i kanë futur kokat shumë thellë në strajcat e tagjisë që ua mbush Piktori.

A e keni vërejtur se Shqipëria nuk është as shtet demokratik, as diktaturë dhe as autokraci, por është shndërruar në një hajdutokraci?



Piktori e shpalli Shipërinë pronë të veten sepse kjo u shkonte për shtati edhe pronarëve të mediave, elitave shoqërore, mendimtarëve të 'pavarur', akademikëve, profesorëve, artistëve... të gjithë atyre që ushqeheshin në grazhdin e hajdutokracisë.
Dhe sot, kur rrugëve të Tiranës jehonë zëri i krenarisë dhe i shpresës rinore, sot pra kur rinia shqiptare dëshmoi se jo çdo shqiptar shitet dhe e tradhton atdheun, shtohet numri i atyre që thonë se do të ishte mirë që Piktori të dorëhiqej.

Dhe gjithnnjë e më të paktë janë ata që nuk e dinë se dorëheqja e tij nuk është thjesht diçka e duhur, por diçka e domosdoshme.

Rënia e Piktorit në të vërtet është parakusht që të ngrihet Shqipëpria dhe që ky shtet më në fund të pastrohet nga plehu politik i tri dekadave të hajdutokracisë.

A e keni vërejtur pra se si patronazhistët dhe shumica e drejtuesve të PS-së heshtin, se si ua ka mbyll veshët e gojën strajca e tagjisë ku e kanë futur kokën, e të cilën ua mbush Piktori?

Është e pamunudr të mos u ketë rënë në sy nervozizmi i patronazhistëve dhe „Rilindasve“, të cilët i trishton rënia e Piktori dhe e 'Aleancësë së Qelbësirave', ngaqë nuk do ketë kush ua mbushë strajcat e tagjisë.

ORTAKU BESPRERË I RON YEFFETIT

ANDI BUSHATI

Dalja në plan të parë e një biznesmeni kontrovers si Ron Yeffet (ky është emri i përdorur më shumë nga milioneri hebre), që deri më tani njihej vetëm në korridoret e errëta të pushtetit, ka njollosur edhe më shumë kontratën e re të Besës, që Edi Rama po kërkon të gëlltitet nga shqiptarët. Intervista e Çim Pekës me Arben Ahmetajn ka treguar edhe njëherë se, ndërkohë që bën përpjekje publike për kthimin e besimit të qytetarëve, kryeministri vepron në kulisa për ti ngulur thika pas shpine atyre.

Por, deri këtu kemi të bëjmë me një film të konsumuar. Ajo që është interesante e që lidhet me mënyrën propagandistike të Besës, si një orvatje për të shitur ëndërra të mëdha, është rruga që ndoqi Yeffet për tu promovuar, pasi u vendos projekti që atij ti faleshin pasuri publike.

Tani të gjithë e dinë me fakte se ky biznesmen që bënte para me republikat e bananeve në Afrikë, ishte një njohje e vjetër e Edi Ramës. Falë mikut kryeministër ai kishte dashur të negocionte borxhin e jashtëm të vendit, të rrëmbente truallin e ambasadës sonë në New York, apo të bëhej partneri i kompanisë tashmë të falimentuar, Air Albania. E



megjithatë, interesante është të shihet se më ç‘kujdes u pergatit futja e tij në skenë.

Për më tepër se një vit, Edi Rama pompoi një sipërmarëse të re që kishte lënë Turqinë, për të vijuar ëndrrën e prodhimit të makinave në vendin e saj. Ai e ftoi Arieta Pucën në podkastin e vet “Flasim”, e bëri të tregojë fëmijërinë, adoleshencën familjen dhe Bulqizën prej nga vinte. Përkundi në sytë e publikut vegimin se, për herë të parë edhe në këtë tokë, ku dikur të kishte një veturë konsiderohej krim, tani do të prodhoheshin makina 100% “made in Albania”. Madje me një ceremonialitet teatral ai i tha Arietës që e dëgjonte si një kukull naive: “Unë do të vij të punoj falas si hamall në kompaninë tënde”. Mediat që marin urdhër u vunë të gjitha në punë për ti bërë reklamë kësaj bjondineje të re, të cilës i kishte bërë porosi për karroceri ambulancash edhe vetë OKB-ja. Fabula e sipërmarëses që e shpie industrinë tonë në maja të paimagjinuara u vu në punë.

Po ç‘fshiej pas saj? Në pranverën e vitit 2025 qeveria mori vendim për të krijuar partneritet publik privat në fushën e mbrojtjes. Kompania shtetërore Kayo (regjizori ishte kujdesur edhe për emrat, duke evokuar atentatorin Kajo Karafili dhe per makinat emrin Shota, sipas gruas së Azem Galicës), u fut në marëdhënie për të krijuar një ndërmarrje të përbashkët me Timak, të Arjeta Pucës. Kjo e fundit 80%, shteti vetëm 20%.
Në të njëjtën distancë të papërfillshme kohore Arieta Puca, pra sirena e industrisë ushtarake rilindase, e shiti për 500 euro, gjysmën e kompanisë së saj. Po kujt? Këtu del sërish në skenë Ron Yeffet. Me ato para xhepi ai bëhet atutomatikisht pronar i një 40 %-shi, që merr fonde nga buxheti i shtetit, por duke iu shmangur çdo lloj kontrolli, gare publike apo tenderi (e thotë edhe përgjatë përgjimit, si në Shqipëri po ashtu edhe në Afrikë: ai i urren ato).

Episodi i hapjes së perdes për të është një mizanskenë e kuruar me talent. Alibitë janë të gjitha gati: Krijimi i kompanisë të re nuk po bëhet me qëllim përfitimi personal, por për të furnizuar denjësisht ushtrinë shqiptare me armatim, madje edhe për ti rishitur ato si një aktor dinjitoz në tregun ndërkombëtar. Favori nuk po i bëhet një miku personal të Ramës, por po stimulohet një pioniere e afirmuar e indusrisë shqiptare të luftës. Në këtë skenar, ku regjizori i ka lënë Arieta Pucës një rol qëndror, ajo është në fakt vetëm idiotja e dobishme e fabulës. Ajo natyrisht mund të punojë dhe fitojë diçka, por i gjithë promovimi, shfaqja në podkast, jehona mediatike që e fryu historinë e suksesit të një emigranteje dhe përkundja e ëndrrës së futjes së Shqipërisë në tregun ndërkombëtar luftarak, i shërben një tjetër qëllimi: dërgimin pa asnjë kontroll në duar të Ron Yeffet, të parave të buxhetit të shtetit.

Ky është, në fakt, thelbi i kësaj historie, të përsëritur me dhjetra herë këto 13 vjet, që nga ndërhyrja mbi Lazarat për të kanabizuar më pas gjithë vendin, që nga “Fundi i marrëzisë”, për të kapur lojrat e fatit e deri fryrja e alarmit të plehrave në qytete për ti hapur rrugë inceneratorëve, apo përqëndrimi i tenderave te një strukture inovatore si AKSH, për ti kaluar realisht te Ergys Agasi.

Por, sa do i madh të ketë qenë dëmi apo gropa financiare e këtyre precedentëve, nga pikpamja e trillimit artistik, përdorimi i fabulës së Arietës, për ti hapur rrugën Ronit, nuk ka të krahasuar për nga gjenialiteti me paraardhësët. E duke thënë “Chapeau artiste” për këtë `fiction`, ndërsa rishikojmë episodet e tij, ne kuptojmë më mirë edhe devizën e rilindjes: Sa më e madhe ëndrra që hidhet në treg, aq më e rëndë është goditja financiare që po përgatitet.

Kjo është metoda e konfirmuar e punës së ortakut besprerë të Ron Yeffet. E prandaj me të njëjtën logjikë duhet kërkuar edhe se ç‘qëndron pas platformës që ai po propogandon javët e fundit, me të madhe, para shqiptarëve. Mos ndoshta pas kësaj ëndërre me një besëlidhje të re qëndrojnë gropat që po përgatiten në shëndetësi dhe në përdorimin e teknologjisë së epokës post AKSH?



Te gjitha produktet e Ballkanit ne nji Market

HILAL FOOD CENTRE
HALAL
INTERNATIONAL SUPERMARKET

318-324 Kilburn High Road, London, NW6 2QN | Tel: 020 7372 1059



190 Merton High Street
Wimbledon
London SW19 1AX



RASHID & RASHID
Solicitors, Advocates
Immigration Specialists
Commissioners of Oaths

Ne mund t'ju ndihmojmë

- Asylum & Immigration
- New Point Based System
- Settlement Applications (ILR)
- European Law
- Nationality&Travel Document
- Human Rights Applications
- High/Court of Appeals
- Over Stayers
- Work Premits
- Visa Extensions
- Judicial Reviews
- Tribunal Appeals



Konsultimet falas

07774222062
07878335000
TEL: 0208 5401 666
TEL: 0208 672 0666



